

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



Implemented
by the Council of Europe

Projekti kundër Krimit Ekonomik në Kosovë* (PKEK)

PYETËSOR

**mbi përputhjen me standardet ndërkombëtare
në fushën e luftimit të pastrimit të parave dhe të
financimit të terrorizmit**

CIKLI 1

ECU/PECK-4/2012

* Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

1.	Të përgjithshme	4
1.1	Informacion i përgjithshëm.....	4
1.2	Gjendja e përgjithshme në fushën e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit	4
1.3	Pamje e përgjithshme e sektorit financiar dhe e Bizneseve dhe Profesioneve të Përcaktuara Jofinanciare (BPPJF).....	5
1.4	Pamje e përgjithshme e ligjeve tregtare dhe mekanizmi që drejton personat juridikë dhe marrëveshjet	6
1.5	Pamje e përgjithshme e strategjisë për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit dhe zbatimi i saj	6
2.	Sistemi ligjor dhe masat institucionale të lidhura.....	8
2.1	Penalizimi i pastrimit të parave.....	8
2.2	Përgjegjësia e personave juridikë.....	11
2.3	Penalizimi i financimit të terrorizmit	13
2.4	Konfiskimi, ngrirja dhe sekuestrimi i të ardhurave nga krimi	15
2.5	Ngrirja e fondeve të shfrytëzuara për financimin e terrorizmit.....	17
2.6	Njësia e Inteligjencës Financiare	20
2.7	Autoritetet e zbatimit të ligjit	23
2.8	Deklarimi apo zbulimi ndërkufitar.....	25
3.	Masat parandaluese – Institucionet financiare	28
3.1	Rreziku i pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizmit	28
3.2	Vigjilenca e duhur ndaj klientëve	28
3.3	Personat e ekspozuar politikisht (PEP)	32
3.4	Ligjet për ruajtjen e fshehtësisë që janë në përputhje me rekomandimet	33
3.5	Mbajtja e regjistrave	34
3.6	Raportimi i transaksioneve të dyshimta në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit	35
3.7	Mbrojtja dhe ndalimi i zbulimit të informacionit.....	36
3.8	Bankat Guaskë (pa prani fizike në vend)	37
3.9	Mbikëqyrja dhe Monitorimi i Vazhdueshëm dhe Hyrja në Treg	37
3.10	Mbikëqyrësit	39
3.11	Sanksionet.....	40
3.12	Shërbimet e transferimit të parasë apo të vlerës.....	41
3.13	Teknikat bashkëkohore të transaksioneve të sigurta	42
4.	Personat juridikë – Qasja në informacionin rreth pronësisë së vlefshme dhe kontrollit.....	43
5.	Organizatat jofitimprurëse	44
6.	Bashkëpunimi ndërkombëtar	46
6.1	Bashkëpunimi dhe bashkërendimi	46
6.2	Ndihma e ndërsjellë juridike	47
6.3	Ndihma e ndërsjellë juridike për konfiskimin dhe ngrirjen e pasurisë	49
6.4	Mënyrat e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar.....	50
	Shtojcat.....	55

SHËNIM PËR AUTORITETET:

- Autoritetet duhet të japin përgjigje të plota dhe të hollësishme për çdo pyetje më poshtë, dhe të shpjegojnë në një masë sa më të plotë që të jetë e mundur kuadrin ligjor dhe institucional dhe/ose masat e tjera që kanë marrë për plotësimin e çdo kriteri të standardeve ndërkombëtare.
- Në mbështetje të përgjigjeve të pyetësorit të mëposhtëm, autoritetet duhet të ofrojnë kopje të legjislacionit dhe dokumente të tjera, të cilat janë përmendur dhe/ose referuar në përgjigjet ndaj pyetjeve.
- Statistikat e kërkuara duhet të ofrohen (nëse ekzistojnë) në formën e një tabele, të ndara sipas viteve për një periudhë 3-vjeçare.
- Gjatë përgjigjes së pyetjeve që kanë të bëjnë me burimet e agjencisë, ju lutem jepni informacion të hollësishëm për buxhetin, personelin, strukturën si dhe një vlerësim gjithëpërfshirës mbi mjaftueshmërinë e burimeve të ndara.

1. Të përgjithshme

1.1 Informacion i përgjithshëm

Ju lutem jepni informacion të përgjithshëm për Kosovën dhe ekonominë e saj. Informacioni tjetër që mund të jetë i përshtatshëm do të ishte një përmbledhje e shkurtër, ku trajtohet respektimi i parimeve, si:

- a) transparenca dhe qeverisja e mirë;
- b) një kulturë e duhur e luftimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit e ndarë bashkërisht dhe e përforcuar nga ana e autoriteteve, institucioneve financiare, bizneseve dhe profesioneve të caktuara jofinanciare; grupeve tregtare të industrisë, dhe të Organizatave Vetërregulluese (OV);
- c) masa të përshtatshme për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin, përfshirë, aty ku informacioni është në dispozicion, ligjet dhe masat e tjera përkatëse, pjesëmarrjen e autoriteteve në nismat rajonale apo ndërkombëtare kundër korrupsionit dhe ndikimi i këtyre masave në zbatimin e luftimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit nga autoritetet;
- d) një sistem gjyqësor i cili siguron që vendimet gjyqësore të zbatohen në mënyrën e duhur;
- e) kërkesa të larta etike dhe profesionale për punonjësit e policisë, prokurorët, gjyqtarët, etj., dhe masat e mekanizmat për të siguruar zbatimin e tyre;
- f) një sistem për të siguruar sjelljen etike dhe profesionale nga ana e profesionistëve, siç janë kontabilistët dhe auditorët, si dhe avokatët. Kjo mund të përfshijë ekzistencën e kodeve të sjelljes dhe të praktikave të mira, si dhe metodat për të siguruar përputhshmërinë, siç janë regjistrimi, licencimi dhe mbikëqyrja.

Ju lutem përfshini informacion të përmbledhur mbi nivelin e zhvillimit të juridiksionit dhe të faktorëve të tjerë, të cilët ndikojnë në zhvillimin dhe zbatimin e kuadrit të luftimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.

1.2 Gjendja e përgjithshme në fushën e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit

Ju lutem jepni informacion për rreziqet dhe dobësitë aktuale, të cilat ballafaqohen nga Kosova në luftimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit dhe si trajtohen ato. Për më tepër, ky seksion duhet të shfrytëzohet për të ofruar informacionin e përgjithshëm për llojet e veprave penale kryesore, të cilat gjenerojnë të ardhura të jashtëligjshme që janë pastruar (dhe nëse shkeljet e pastrimit të parave janë para së gjithash të bazuara në veprat penale kryesore që ndodhin në vend apo jashtë), ndonjë vlerësim të shumës së parave të pastruara, si dhe metodat, teknikat dhe prirjet të cilat janë vëzhguar lidhur me pastrimin. Duhet të ofrohet gjithashtu informacion për çfarëdo veprimtarie terroriste, e cila ka ndodhur në Kosovë, si dhe për burimet dhe metodat e shfrytëzuara për të financuar veprimtaritë terroriste.

Duhet t'u jepet përgjigje pyetjeve në vazhdim:

- (a) Cilat krime apo lloje të krimeve konsiderohen të jenë burimet kryesore të të ardhurave të jashtëligjshme në juridiksionin tuaj? Ju lutem përshkruani shkurtimisht gjendjen e tanishme dhe prirjet lidhur me krime të tilla, p.sh.: sa serioz mund të paraqitet problemi i pastrimit të parave; ndonjë mënyrë të vlerësimit të madhësisë së shkallës së të ardhurave të krijuara që mund të ofroni; nëse shkalla e ndodhjes së krimeve të tilla është në rritje apo në rënie, dhe nëse të ardhurat vijnë nga veprat penale kryesore që ndodhin në vend apo jashtë tij.

Ju lutem jepni, nëse është e mundshme, të dhëna statistikore në dispozicion mbi numrin e ndjekjeve penale dhe të dënimeve për vepra penale të rënda; sipas llojit të veprës/shkeljes për katër (4) vitet e fundit. Kjo do të ndihmojë vlerësuesit që të kenë një pasqyrë të gjendjes së krimit në përgjithësi. Për veprat të cilat rezultojnë me humbje apo dëm ekonomik, ju lutem tregoni (nëse shifrat janë në dispozicion) humbjen apo dëmin e përgjithshëm ekonomik i cili ka rezultuar nga vepra të tilla.

(b) Përshkruani gjendjen e tanishme të pastrimit të parave në juridiksionin tuaj dhe si ka ndryshuar (nëse ka ndryshuar) ajo gjatë katër (4) viteve të fundit? Cili konsideroni të jetë problemi juaj më i rëndësishëm i pastrimit të parave? A parashikoni ndonjë ndryshim në kërcënimin prej pastrimit të parave në një të ardhme të parashikueshme? Në përshkrimin tuaj, ju lutem ofroni llojet e mëposhtme të informacionit:

- (1) numri i rasteve të pastrimit të parave apo i rasteve të dyshuara të pastrimit të parave;
- (2) mënyrat më të zakonshme të pastrimit të parave;
- (3) llojet e institucioneve financiare, Bizneseve dhe Profesioneve të Përcaktuara Jofinanciare (BPPJF) apo bizneseve të tjera të përdorura;
- (4) llojet e grupeve të përfshira në operacionet e pastrimit;
- (5) nëse modeli i pastrimit të parave ka ndryshuar pas futjes së masave kundër pastrimit të parave.

(c) Përshkruani gjendjen e tanishme të financimit të terrorizmit në Kosovë dhe si ka ndryshuar (nëse ka ndryshuar) gjatë katër (4) viteve të fundit? A parashikoni ndonjë ndryshim në metodat apo teknikat të cilat do të shfrytëzohen në të ardhmen e parashikueshme? Në përshkrimin tuaj, mbulonit çfarëdo rastesh të tanishme apo të dyshuara të financimit të terrorizmit që janë zbuluar, burimin e financimit (përfshirë faktin nëse është i ligjshëm ose i jashtëligjshëm), mënyrat me të cilat fondet u janë ofruar terroristëve dhe si janë shfrytëzuar ato, llojet e institucioneve të shfrytëzuara, si dhe grupet e përfshira). Njoftoni nëse teknikat dhe prirjet e financimit të terrorizmit kanë ndryshuar pas futjes së masave kundër financimit të terrorizmit.

1.3 Pamje e përgjithshme e sektorit financiar dhe e Bizneseve dhe Profesioneve të Përcaktuara Jofinanciare (BPPJF)

Ju lutem jepni një përshkrim të llojeve të institucioneve financiare që funksionojnë në Kosovë, dhe një listë të veprimtarive financiare në të cilat ato janë të angazhuara apo janë të autorizuar për t'u angazhuar.¹ Është shumë e dobishme nëse përgatitet një tabelë që krahason

¹ Sipas rekomandimeve të FATF-së *institucion financiar* do të thotë çdo person apo ent i cili kryen si biznes një apo më shumë veprimtari ose operacione të mëposhtme për ose në emër të një klienti:

1. Pranimi i depozitave dhe fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku.
2. Huadhënia.
3. Huadhënia financiare.
4. Transferimi i parave ose i vlerave.
5. Nxjerrja dhe menaxhimi i mjeteve të pagesës (p.sh.: kartat e kredisë dhe debisë, çeket, çeket e udhëtarit, urdhërpagesat dhe urdhërpagesat bankare, paratë elektronike).
6. Garancitë dhe angazhimet financiare.
7. Tregtimi i:
 - (a) instrumenteve të tregut të parasë (çeqe, fatura, CD, derivate, etj.);
 - (b) shkëmbimit valutor të jashtëm;
 - (c) shkëmbimit, normës së interesit dhe instrumenteve të indeksimit;
 - (d) letrave me vlerë të transferueshme;
 - (e) tregtimi i ardhshëm i mallrave.
8. Pjesëmarrja në çështjet e letrave me vlerë dhe dhënia e shërbimeve financiare të lidhura me këto çështje.

llojet e institucioneve financiare që funksionojnë në Kosovë me listën e veprimtarive financiare të përcaktuar në përkufizimin e Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF). Për qëllimet e rekomandimeve të FATF-së, nuk është e domosdoshme që një biznes apo institucion të kërkojë autorizim për t'u klasifikuar si "institucion financiar". Për më tepër, ky seksion duhet të përshkruajë çdo person fizik ose juridik i cili angazhohet në veprimtari financiare dhe që përmbush përkufizimin e "institucionit financiar". Ky seksion duhet të paraqesë informacion në lidhje me numrin dhe madhësinë e institucioneve financiare, si dhe çfarëdo ndryshimi domethënës të kohëve të fundit, p.sh.: konsolidimi në një sektor të caktuar.

1.4 Pamje e përgjithshme e ligjeve tregtare dhe mekanizmi që drejton personat juridikë dhe marrëveshjet

Ju lutem jepni një përshkrim të llojeve të personave juridikë dhe të marrëveshjeve juridike të cilat mund të themelohen apo krijohen, apo që mund të zotërojnë pronë në Kosovë. Kjo mund të përfshijë edhe llojet e personave dhe të marrëveshjeve juridike, të cilat nuk mund të themelohen a krijohen në Kosovë, por që pranohen për qëllime të tilla, siç janë mbajtja e llogarisë bankare apo e pronës së paluajtshme, zotërimi i aksioneve ose kryerja e transaksioneve financiare. Kosova duhet të japë informacione themelore për sa më poshtë:

(a) si janë krijuar apo themeluar apo si njihen ndryshe personat a marrëveshjet e tilla juridikë, p.sh.: cilat dokumente zyrtare nevojiten;

(b) karakteristikat themelore të enteve të tilla, p.sh.: kush ka pronësi (për shembull aksionarët, të cilët mund të jenë persona juridikë apo fizikë) dhe kontroll (p.sh.: drejtorët), a kanë nevojë për një zyre apo agjent të regjistruar, etj;

(c) nëse ato janë regjistruar, cilat lloje të informacionit duhet të jepen për regjistrin (në veçanti, informacioni për pronësinë dhe kontrollin), dhe nëse ky është informacion publik; dhe

(d) cilat lloje të informacionit në lidhje me pronësinë dhe kontrollin e tyre duhet të mbahen nga vet enti, kush ka qasje në këtë informacion dhe nëse ai duhet të mbahet/ruhet në Kosovë, ku është krijuar apo themeluar ose ku janë pronarët e pronës.

Është shumë e dobishme nëse ky seksion do të përmbajë gjithashtu një përshkrim të çfarëdo ligji, sistemi apo mekanizmi i cili ekziston për të identifikuar personat fizikë, të cilët mund të jenë nëpërmjet sistemeve në vend për regjistrimin e identitetit ose përmes shfrytëzimit të kartave të identitetit a në ndonjë mënyrë tjetër.

1.5 Pamje e përgjithshme e strategjisë për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit dhe zbatimi i saj

Ju lutem jepni një pasqyrë të nivelit të lartë mbi përpjekjet në luftimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit në Kosovë, dhe në veçanti objektivat e politikës. Nuk është e

9. Menaxhimi i portofolit individual dhe kolektiv.

10. Ruajtja dhe administrimi i parave apo letrave me vlerë fizike në emër të personave të tjerë.

11. Investimi, administrimi apo menaxhimi i fondeve ose parasë në emër të personave të tjerë.

12. Nënshkrimi dhe investimi për sigurimin e jetës dhe investime të tjera të lidhura me sigurimin.

13. Këmbimi i parave dhe valutës.

domosdoshme të jepet një pasqyrë e tërë sistemit, pasi të gjithë përbërësit legjislativë dhe të tjerë do të përshkruhen me hollësi më poshtë, dhe meqenëse përmbledhja ekzekutive e Raportit të Vlerësimit të Ndërsjellë (RVN) do të na ofrojë këtë pasqyrë. Ajo duhet të përmbajë identifikimin e autoriteteve, organeve dhe të institucioneve me përgjegjësi në luftimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizimit në Kosovë, dhe një përmbledhje të zhvillimeve historike. Përgjigjet e pyetjeve të mëposhtme do të ndihmojnë në sigurimin e një bazë të rëndësishme për të plotësuar këtë seksion.

2. Sistemi ligjor dhe masat institucionale të lidhura

2.1 Penalizimi i pastrimit të parave

2.1.1 A është bërë penalizimi i pastrimit të parave sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1988 kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe të Lëndëve Psikotrope (Konventa e Vjenës) dhe sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara të vitit 2000 kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (Konventa e Palermos) ndërmjet të tjerash elementët fizikë dhe materialë të veprës (shih nenin 3(1)(b)&(c) të Konventës së Vjenës dhe nenin 6(1) të Konventës së Palermos? (FATF R.1.1)
2.1.2 A është e shtrirë vepra e pastrimit të parave në secilin lloj të pronës, pavarësisht vlerës së saj, e cila në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë paraqet të ardhurat nga krimi? (FATF R.1.2)
2.1.3 Kur provohet se prona ka rrjedhur nga krimi, a është e domosdoshme që personi të dënohet për veprën penale kryesore? (FATF R.1.2.1)
2.1.4 A mbulohen të gjitha veprat e rënda nga veprat penale kryesore të pastrimit të parave, dhe a synon Kosova ta zgjerojë këtë gamë të veprave penale ² ? (FATF R.1.3)
2.1.5 Nëse Kosova zbaton një qasje të pragut ³ apo një qasje të kombinuar e cila e përfshin qasjen e pragut, a përfshijnë veprat penale kryesore së paku të gjitha veprat penale që: a) hyjnë në kategorinë e veprave të rënda penale sipas ligjit të tyre të brendshëm; apo b) janë të dënueshme me një dënim maksimal prej më shumë se një vit burgim; ose c) dënohen të paktën prej më shumë se gjashtë muaj burgim (për shtetet që kanë një prag minimal për veprat penale në sistemin e tyre ligjor)? (FATF R.1.4)
2.1.6 A shtrihen veprat penale kryesore të pastrimit të parave për sjelljen që ka ndodhur në një juridiksion tjetër e cila përbën një vepër penale në atë juridiksion, dhe që do të përbënte vepër penale kryesore nëse do të kishte ndodhur në vend? (FATF R.1.5)
2.1.7 A zbatohet vepra penale e pastrimit të parave ndaj personave të cilët kanë kryer veprën penale kryesore (FATF R.1.6)

2 Veprat penale kryesore duhet të përfshijnë së paku një gamë të veprave penale në secilën kategori të të përcaktuar të veprave penale (shih shtojcën 1). Kur kategoria e përcaktuar është e kufizuar në një vepër të veçantë, atëherë ajo vepër penale duhet të mbulohet.

3 Vendet i përcaktojnë veprat penale kryesore të pastrimit të parave, duke iu referuar (a) të gjitha veprave penale, apo (b) një pragu i cili është i lidhur qoftë me një kategori të veprave penale të rënda apo me dënimet me burgim që zbatohen për veprat penale kryesore (qasja e pragut), apo (c) një liste të veprave penale kryesore, apo (d) një kombinimi të këtyre qasjeve.

2.1.8 A ekzistojnë vepra penale të duhura ndihmëse për veprën penale të pastrimit të parave, duke përfshirë lidhjen me apo komplotin për të kryer, tentuar, ndihmuar apo nxitur, lehtësuar, dhe këshilluar kryerjen e veprës penale, përveç nëse kjo nuk lejohet nga parimet themelore të ligjit vendas? (FATF R.1.7)
2.1.9 Aty ku të ardhurat e krimit rrjedhin nga sjellja e cila ka ndodhur në një juridiksion tjetër, e cila nuk përbën një vepër penale në atë shtet, por e cila do të përbënte një vepër penale kryesore nëse të kishte ndodhur brenda vendit, atëherë a paraqet kjo një vepër penale të pastrimit të parave? (FATF R.1.8)
2.1.10 A lejojnë legjislacioni dhe masat e tjera që të vendoset një vepër penale e pastrimit të parave kur personi dyshon se prona ka qenë produkt i ardhur prej saj? (CETS ⁴ 198 neni 9 (3))
2.1.11 A lejojnë legjislacioni dhe masat e tjera që të cilësohet një vepër penale e pastrimit të parave kur personi duhet të kishte supozuar që prona ka qenë produkt i ardhur prej saj? (CETS 198 neni 9 (3))
2.1.12 A është bërë penalizimi në juridiksionin tuaj i të gjitha kategorive të veprave penale kryesore, të cilat janë të renditura në shtojcën e CETS-it nr. 198 (shih shtojcën 2)? (CETS 198 neni 9 (4))
2.1.13 A mund të jepet një dënim për pastrim të parave pa një kërkesë për dënim paraprak apo të njëkohshëm për veprën penale kryesore? (CETS 198 neni 9 (5))
2.1.14 Si e provoni zbatimin efektiv të kësaj kërkesë? Nëse ka shembuj të statistikave të cilat vërtetojnë kushtin e vendosur në nenin 9 (5) të CETS-it nr. 198 me raste të ndodhura në juridiksionin tuaj, ju lutem jepini ato.
2.1.15 A është i mundur dënimi për pastrim të parave aty ku vërtetohet se prona, objekt i paragrafit 1a ose b të nenit 9, ka prejardhje nga një vepër penale kryesore, pa qenë e nevojshme që të vërtetohet në mënyrë të saktë se për cilën vepër penale bëhet fjalë? (CETS 198 neni 9 (6))

4 CETS (Council of Europe Treaty Series) është shkurtimi për emërtimin “Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës” i cili përdoret për traktatet nr.194 e në vijim. Konventat e marrëveshjet e hapura për nënshkrim ndërmjet viteve 1949 deri në 2003 janë botuar në “European Treaty Series” (Seria e Traktateve Evropiane, ETS nr.001 deri në 193 të përfshirë).

2.1.16 Kur bëhet përcaktimi i dënimit, cilat masa legislative dhe të tjera në juridiksionin tuaj sigurojnë mundësinë e marrjes parasysh të vendimeve përfundimtare (të formës së prerë) të marra nga një palë tjetër kundër personave fizikë dhe juridikë në lidhje me veprat penale? (CETS 198 neni 11)
2.1.17 A mbajnë autoritetet kompetente në Kosovë statistika të plota për hetimet, ndjekjet penale dhe dënimet për pastrim të parave? Nëse po, ju lutem jepini këto statistika (FATF R.32.2). Ju lutem tregoni çfarëdo të dhëne apo material tjetër që ju i konsideroni të përshtatshëm për efikasitetin dhe efektshmërinë e kësaj pjesë të sistemit të luftimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.

2.2 Përgjegjësia e personave juridikë

2.2.1 A zbatohet vepra penale e pastrimit të parave së paku për personat fizikë, të cilët angazhohen me dashje në veprimtari të pastrimit të parave? (FATF R.2.1)
2.2.2 A lejon ligji që elementi i qëllimshëm i veprës penale të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit të nxirret nga rrethanat faktike objektive? (FATF R.2.2 dhe Rekomandimi i Veçantë - RV.II.4)
2.2.3 A zbatohet përgjegjësia penale për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit edhe ndaj personave juridikë? Nëse kjo nuk është e mundur (ndërmjet të tjerash, për shkak të parimeve themelore të ligjit vendas), a zbatohet përgjegjësia civile apo administrative? (FATF R.2.3 dhe RV.II.4)
2.2.4 Nëse personi juridik është subjekt i përgjegjësisë penale për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit, a përjashton kjo mundësinë e procedurës paralele penale, civile apo administrative në vendet ku më shumë se një formë e përgjegjësisë është në dispozicion? (FATF R.2.4 dhe RV.II.4)
2.2.5 A janë personat fizikë dhe juridikë subjekt i sanksioneve penale, civile apo administrative të efektshme, proporcionale dhe shtrënguese për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit? (FATF R.2.5 dhe RV.II.4)
2.2.6 A mbajnë përgjegjësi personat fizikë dhe juridikë për shkeljet e dispozitave të luftimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit të përcaktuara në legjislacionin vendas? (Direktiva e Tretë për Pastrimin e Parave – D3PP neni 39)
2.2.7 Si mbajnë përgjegjësi personat fizikë dhe juridikë për veprat penale të pastrimit të parave të parashikuara në përputhje me CETS nr. 198 të kryera për përfitime të veta personale nga cili person fizik, i cili vepron qoftë individualisht apo si pjesë e një organi të personit juridik dhe që ka një pozicion drejtues në kuadër të personit juridik, duke u bazuar në: a) të drejtën e përfaqësimit të personit juridik; apo b) autoritetin për të marrë vendime në emër të personit juridik; ose c) autoritetin për të ushtruar kontroll në kuadër të personit juridik si dhe në përfshirjen e një personi fizik si bashkëpunëtor apo nxitës i veprave penale të lartpërmendura? (CETS 198 neni 10 (1))
2.2.8 Si zbatohet nocioni i përgjegjësisë së shoqërive ndaj personave juridikë në rastet ku mungesa e mbikëqyrjes apo kontrollit nga ana e personit fizik i cili ka një pozicion drejtues në personin juridik ka bërë të mundur kryerjen e veprave penale në paragrafin 1 në përfitim të

atij personi juridik nën autoritetin e tij? (CETS 198 neni 10 (2))
2.2.9 Kur bëhet përcaktimi i dënimit, cilat masa legislative dhe të tjera në juridiksionin tuaj sigurojnë mundësinë e marrjes parasysh të vendimeve përfundimtare të formës së prerë të marra nga një palë tjetër kundër personave fizikë ose juridikë në lidhje me veprat penale të parashikuara? (CETS 198 neni 11)

2.3 Penalizimi i financimit të terrorizmit

2.3.1 A është penalizuar financimi i terrorizmit në përputhje me nenin 2 të Konventës për Financimin e Terrorizmit? (FATF RV.II.1)
2.3.2 A shtrihen veprat penale të financimit të terrorizmit ndaj çdo personi, i cili me paramendim jep apo mbledh fonde me çfarëdo mjeti, drejtpërdrejt apo tërthorazi, me qëllimin e paligjshëm që ato të shfrytëzohen apo me dijeninë që ato do të shfrytëzohen, tërësisht apo pjesërisht: (i) për të kryer një akt (akte) terrorist; (ii) nga një organizatë terroriste; apo (iii) nga një terrorist i vetëm. (FATF RV.II.1 (a))
2.3.3 A shtrihen veprat penale të financimit të terrorizmit në çdo fond, ashtu siç është përkufizuar kjo fjalë në Konventën për Financimin e Terrorizmit ⁵ ? A përfshin kjo fondet nga burimet e jashtëligjshme si dhe ato të ligjshme? (FATF RV.II.1 (b))
2.3.4 A kërkojnë veprat penale të financimit të terrorizmit që fondet: (i) të shfrytëzohen në të vërtetë për të kryer apo për të tentuar që të kryhet një apo më shumë akte terroriste; ose (ii) janë të lidhura më një apo më shumë akte terroriste të veçanta. (FATF RV.II.1 (c))
2.3.5 A përbën vepër penale tentativa për të bërë financimin e terrorizmit? (FATF RV.II.1 (d))
2.3.6 A përbën vepër penale fakti kur një person është i angazhuar në cilindo nga llojet e sjelljes të përcaktuara në nenin 2(5) të Konventës për Financimin e Terrorizmit? (FATF RV.II.1 (e))
2.3.7 A janë veprat penale të financimit të terrorizmit vepra penale kryesore të pastrimit të parave? (FATF RV.II.2)
2.3.8 A zbatohen veprat penale të financimit të terrorizmit, pavarësisht nëse personi që supozohet të ketë kryer veprën (veprat) penale është në të njëjtin shtet apo në një shtet tjetër nga ai në të cilin terroristët/organizata (organizatat) terroriste janë të vendosura apo akti

⁵ Konventa për Financimin e Terrorizmit i përkufizon *fondet* si “pasuri të çdo lloji, të prekshme apo të paprekshme, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht se si janë vënë, dhe dokumente ligjore ose instrumente të çdo forme, përfshirë ato elektronike apo dixhitale, që dëshmojnë të drejtat ose interesin në pasuri të tilla, përfshirë, por pa u kufizuar, kreditë bankare, çeket e udhëtarëve, çeket bankare, mandatpagesat, aksionet, letrat me vlerë, bonot, urdhërpagesat, letrat e kreditit.”

(aktet) terroriste kanë ndodhur apo do të ndodhin? (FATF RV.II.3)
2.3.9 A mbajnë autoritetet kompetente në Kosovë statistika gjithëpërfshirëse për hetimet, ndjekjet penale dhe dënimet për financim të terrorizmit? Nëse po, ju lutem ofroni këto statistika (FATF R.32.2). Ju lutem tregoni çfarëdo të dhëne apo materiali tjetër që ju konsideroni të jetë i përshtatshëm për efikasitetin dhe efektshmërinë e kësaj pjesë të sistemit të luftimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.

2.4 Konfiskimi, ngrirja dhe sekuestrimi i të ardhurave nga krimi

2.4.1 A parashikojnë ligjet konfiskimin e pronës⁶, e cila është pastruar apo e cila përbën: a) të ardhura nga; b) instrumente të shfrytëzuara në; dhe c) instrumente me qëllim për t'u shfrytëzuar në kryerja/kryerjen e ndonjë veprë penale të pastrimit të parave apo të financimit të terrorizmit ose të veprave të tjera penale kryesore, dhe të pronës me vlerë përkatëse? (FATF R.3.1)
2.4.2 A zbatohen ligjet e mësipërme në mënyrë të barabartë: (a) për pronën e cila rrjedh në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë nga të ardhurat e krimit; duke përfshirë të ardhurat, përfitimet dhe të mirat e tjera nga të ardhurat e krimit; dhe (b) për të gjithë pronën e referuara më lart, pavarësisht nëse ajo mbahet apo është në zotërim të një të pandehuri për vepër penale apo nga një palë e tretë? (FATF R.3.1.1)
2.4.3 A parashikojnë ligjet dhe masat e tjera masa të përkohshme, përfshirë ngrirjen dhe/apo sekuestrimin e pronës, për të parandaluar çfarëdo trajtimi, transferimi apo tjetërsimi të pronës e cila është subjekt i konfiskimit? (FATF R.3.2)
2.4.4 A lejojnë ligjet dhe masat e tjera zbatimin fillestar për ngrirjen apo sekuestrimin e pronës e cila është subjekt i konfiskimit që të kryhet në mënyrë të njëanshme apo pa paralajmërim paraprak, përveç nëse kjo është në kundërshtim me parimet themelore të ligjit vendas? (FATF R.3.3)
2.4.5 A u janë dhënë kompetencat e duhura agjencive të zbatimit të ligjit, Njësisë së Inteligjencës Financiare (NjIF) apo autoriteteve të tjera kompetente për të identifikuar dhe gjurmuar pronën e cila është, apo mund të jetë subjekt i konfiskimit apo për të cilën dyshohet se ka rrjedhur nga të ardhurat e krimit? (FATF R.3.4)
2.4.6 A parashikojnë ligjet dhe masat e tjera mbrojtje për të drejtat e palëve të treta në mirëbesim? (FATF R.3.5)
2.4.7 A ekziston një autoritet për të ndërmarrë hapa për të parandaluar apo për të bërë të pavlefshme veprimet, qofshin ato kontraktore apo të tjera, ku personat e përfshirë kanë ditur apo duhet të kenë qenë në dijeni që si rezultat i atyre veprimeve autoritetet do të paragjykojnë aftësinë e tyre për të rimarrë pasurinë e cila është subjekt i konfiskimit? (FATF R.3.6)

⁶ E gjithë prona e cila është referuar në kriteret e mësipërme 3.1 dhe 3.1.1 do të referohet këtu e tutje si “pronë subjekt i konfiskimit”.

2.4.8 A parashikohet në ligj konfiskimi i: a) pronës së organizatave për të cilat është zbuluar se janë kriminale për nga natyra (ndërmjet të tjerash, organizatat funksioni kryesor i të cilave është të kryejnë apo të ndihmojnë në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme)? b) pronës e cila është subjekt i konfiskimit, por pa dënimin e ndonjë personi (marrja e pronës me procedurë civile), përveç sistemit të konfiskimit të shkaktuar nga një dënim penal? c) pronës e cila është subjekt i konfiskimit, dhe e cila kërkon që një shkelës të vërtetojë origjinën e ligjshme të pasurisë? (FATF R.3.7)
2.4.9 Me ligjin tuaj të brendshëm a mund të bashkëpunoni me palët të cilat kërkojnë ekzekutimin e masave të barasvlershme me konfiskimin që shpie drejt humbjes së pronës, të cilat nuk janë sanksione penale, për aq sa këto masa janë urdhëruar nga një autoritet gjyqësor i palës kërkuese në lidhje me një vepër penale? A keni dhënë ndonjë ndihmë ndërkombëtare mbi këtë bazë? (CETS 198 neni 23.5)
2.4.10 Kur veproni me kërkesë të bërë nga një palë tjetër në përputhje me nenin 23 dhe 24 të CETS nr. 198, autoritetet tuaja, deri në një masë të lejuar nga ligji vendas dhe nëse kërkohet një gjë e tillë, a japin prioritet për t'i kthyer pronën e konfiskuar palës kërkuese në mënyrë që të mund t'u japë kompensimin viktimave të krimit apo t'ua kthejë këtë pronë pronarëve të saj të ligjshëm? Si arrihet kjo në praktikë? Ju lutem ofroni dispozitat ligjore përkatëse nëse ekzistojnë. (CETS 198 neni 25.2)
2.4.11 A ekzistojnë marrëveshje apo rregullime të cilat i japin një konsideratë të veçantë ndarjes me palët e tjera të pronës së konfiskuar, në baza të rregullta apo rast pas rasti? (CETS 198 neni 25.3)
2.4.12 A mbajnë autoritetet kompetente në Kosovë statistika gjithëpërfshirëse për numrin e rasteve dhe të sasisë së pronës së ngrirë, të sekuestruar dhe të konfiskuar në lidhje me (i) pastrimin e parave, (ii) financimin e terrorizmit, (iii) të ardhurat kriminale, (iv) veprat penale kryesore që qëndrojnë pas tyre? Nëse po, atëherë ju lutem ofroni këto statistika (FATF R.32.2). Ju lutem tregoni çfarëdo të dhëne apo materiali tjetër të cilën ju konsideroni të jetë i përshtatshëm për efektivitetin dhe efikasitetin e kësaj pjesë të sistemit të luftimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.

2.5 Ngrirja e fondeve të shfrytëzuara për financimin e terrorizmit

2.5.1 A ekzistojnë ligje dhe procedura efektive në Kosovë për të ngrirë fondet terroriste apo pasuritë e tjera të personave të përcaktuar nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Sanksionet ndaj Al-Kaida-s dhe Talebanëve në përputhje me S/RES/1267(1999) ⁷ ? (FATF RV.III.1)
2.5.2 A ekzistojnë ligje dhe procedura efektive në Kosovë për të ngrirë fondet terroriste apo pasuri të tjera të personave të përcaktuar në kontekstin e S/RES/1373(2001) ⁸ ? (FATF RV.III.2)
2.5.3 A ekzistojnë ligje dhe procedura efektive në Kosovë për të shqyrtuar dhe për t'iu dhënë efekt, nëse është e nevojshme, veprimeve të nisura në kuadër të mekanizmave të ngrirjes të shteteve të tjera? (FATF RV.III.3)
2.5.4 A shtrihen veprimet e ngrirjes të përmendura më lart tek: a) fondet apo pasuritë e tjera të cilat tërësisht apo bashkërisht ⁹ janë në pronësi të plotë apo kontrollohen drejtpërdrejt a tërthorazi nga personat e përcaktuar, terroristët, ata që financojnë terrorizmin apo organizatat terroriste; dhe b) fondet apo pasuritë e tjera që rrjedhin apo janë të krijuara nga fonde apo pasuri të tjera të cilat janë zotërohen ose kontrollohen drejtpërdrejt apo tërthorazi nga personat e përcaktuar, terroristët, ata që financojnë terrorizmin apo organizatat terroriste? (FATF RV.III.4)

7 S/RES/1267(1999) dhe rezolutat e tjera që e pasojnë atë i detyrojnë vendet të ngrijnë pa vonesë fondet apo pasuritë e tjera të zotëruara apo të kontrolluara nga Al-Kaida, Talebanët, Osama Bin Laden ose personat dhe ente e tjera të lidhura me ta, siç janë përcaktuar nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Sanksionet ndaj Al-Kaida-s dhe Talebanëve në përputhje me Rezolutën 1267(1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë fondet që rrjedhin nga fonde apo pasuri të tjera të zotëruara ose të kontrolluara, drejtpërdrejt a tërthorazi, prej tyre ose nga persona që veprojnë në emër të tyre ose nën drejtimin e tyre, dhe të sigurojnë se as këto dhe as ndonjë fond apo pasuri tjetër nuk është vënë në dispozicion të tyre, drejtpërdrejt apo tërthorazi, për përfitimin e tyre nga bashkëkombësit e tyre ose nga ndonjë person në territorin e tyre. Komiteti për sanksionet ndaj Al-Kaida-s dhe Talebanëve është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e personave dhe enteve, të cilëve duhet t'u ngrihen fondet apo pasuritë e tjera sipas S/RES/1267(1999) dhe rezolutave pasuese. Të gjitha vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara janë të detyruara nga S/RES/1267(1999) dhe rezolutat e saj pasuese të ngrijnë pasuritë e personave apo enteve të përcaktuara nga Komiteti për Sanksionet ndaj Al-Kaida-s dhe Talebanëve.

8 S/RES/1373(2001) detyron juridiksionet të ngrijnë pa vonesë fondet dhe pasuritë e tjera të personave që kryejnë ose përpiqen të kryejnë, akte terroriste ose marrin pjesë në ose lehtësojnë kryerjen e akteve terroriste; të enteve të zotëruara ose të kontrolluara drejtpërdrejt a tërthorazi nga këta persona; dhe të personave dhe enteve që veprojnë në emër të tyre ose nën drejtimin e këtyre personave apo enteve, përfshirë fonde dhe pasuri të tjera që rrjedhin apo gjenerohen nga pasuritë e zotëruara ose të kontrolluara, drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga këta persona ose personat dhe entet e lidhura me ta. Secili vend, në mënyrë individuale, ka autoritetin të përcaktojë personat dhe entet të cilëve duhet t'u ngrihen fondet dhe pasuritë e tjera. Për të siguruar zhvillimin e bashkëpunimit efektiv midis vendeve, këto të fundit duhet të shqyrtojnë dhe të vënë në zbatim, kur është e mundur, veprimet e nisura me mekanizmat e ngrirjes së juridiksioneve të tjera. Kur (i) dërgohet një njoftim apo komunikim i veçantë dhe (ii) shteti që merr kërkesën është i kënaqur, sipas parimeve ligjore në fuqi, që një përcaktim i kërkuar është i mbështetur në kushte të arsyeshme, ose ka bazë të arsyeshme për të dyshuar apo besuar se i dyshuari i propozuar është një terrorist, dikush që financo terrorizmin ose organizatë terroriste, vendi që merr kërkesën duhet të sigurojë se fondet dhe pasuri të tjera të personit të përcaktuar do të ngrihen pa vonesë.

9 Bashkërisht i referohet asaj pasurie e cila mbahet bashkërisht midis personave të përcaktuar, terroristëve, atyre të cilët financojnë terrorizmin apo organizatave terroriste në njërën anë, dhe të palës apo palëve të treta në anën tjetër.

2.5.5 A ka Kosova sisteme efektive për t'i komunikuar sektorit financiar veprimet e ndërmarra me anë të mekanizmave të ngrirjes të referuara në kriterin e mësipërm menjëherë pasi një veprim i tillë të jetë ndërmarrë? (FATF RV.III.5)
2.5.6 A janë siguruar udhëzime të qarta për institucionet financiare dhe për personat apo entet e tjera, të cilët mund të mbajnë fondet apo pasuritë e tjera të shenjuara në lidhje me detyrimet e tyre për të ndërmarrë veprime me anë të mekanizmave të ngrirjes? (FATF RV.III.6)
2.5.7 A ka Kosova procedura efektive dhe të njohura publikisht për të marrë parasysh kërkesa për heqjen nga lista dhe për të zhbllokuar fondet dhe pasuritë e tjera të personave apo enteve të hequra nga lista në kohën e duhur në përputhje me detyrimet ndërkombëtare? (FATF RV.III.7)
2.5.8 A ka Kosova procedura efektive dhe të njohura publikisht për të zhbllokuar në kohën e duhur fondet dhe pasuritë e tjera të personave apo enteve të prekura pa dashje nga një mekanizëm i ngrirjes pas verifikimit që personi apo enti nuk është personi i përcaktuar? (FATF RV.III.8)
2.5.9 A ka Kosova procedura të duhura për të autorizuar qasje në fondet dhe pasuritë e tjera të cilat janë ngrirë në përputhje me S/RES/1267(1999) dhe të cilat janë përcaktuar si të nevojshme për shpenzimet themelore, pagesën e disa llojeve të caktuara të tarifave, shpenzimeve dhe tarifave të shërbimeve apo shpenzimeve të jashtëzakonshme? ¹⁰ (FATF RV.III.9)
2.5.10 A ka Kosova procedura të duhura përmes të cilave një person apo ent, që ka fonde apo pasuri të tjera të ngrira, të mund të kundërshtojë këtë masë me qëllim që ajo të rishqyrtohet nga gjykata? (FATF RV.III.10)
2.5.11 A parashikojnë ligjet dhe masat e tjera në Kosovë mbrojtje për të drejtat e palëve të treta në mirëbesim? (FATF RV.III.12)
2.5.12 A mbajnë autoritetet kompetente të Kosovës statistika gjithëpërfshirëse për numrin e personave apo enteve dhe për sasinë e pronës së ngrirë në përputhje me Rezolutat e Kombeve të Bashkuara në lidhje me financimin e terrorizmit (FATF R.32.2). Ju lutem tregoni çfarëdo të dhëne apo materiali tjetër që e konsideroni të përshtatshme për efektivitetin dhe efikasitetin e kësaj pjesë të sistemit të luftimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.

¹⁰ Këto procedura duhet të jenë në përputhje me S/RES/1452(2002).

2.6 Njësia e Inteligjencës Financiare

2.6.1 A ka themeluar Kosova një Njësi të Inteligjencës Financiare (NjIF) e cila shërben si qendër për pranimin (dhe nëse lejohet, për kërkimin), analizimin, dhe shpërndarjen e informacionit të deklaruar të Raporteve të Transaksioneve të Dyshimta (RTD) dhe të informatave të tjera përkatëse në lidhje me veprimtaritë e dyshimta të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit? (FATF R.26.1)
2.6.2 A u ka ofruar NjIF-i apo ndonjë autoritet tjetër kompetent institucioneve financiare dhe palëve të tjera raportuese udhëzime në lidhje me mënyrën e raportimit, përfshirë specifikimin e formularëve të raportimit dhe procedurat që duhet të ndiqen kur bëhet raportimi? (FATF R.26.2)
2.6.3 A ka NjIF-i qasje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në periudha të arsyeshme kohore, në informacionin financiar, administrativ dhe të zbatimit të ligjit i cili i nevojitet për të marrë përsipër dhe kryer detyrat e saj, përfshirë analizimin e RTD-ve? (FATF R.26.3)
2.6.4 A është NjIF-i, qoftë drejtpërdrejt apo përmes një autoriteti tjetër kompetent, e autorizuar të marrë informacion plotësues nga palët raportuese i cili i nevojitet për të kryer si duhet detyrat e saj? (FATF R.26.4)
2.6.5 A është NjIF-i e autorizuar të shpërndajë informacion financiar autoriteteve vendase për të hetuar apo vepruar kur ekziston dyshimi i bazuar për pastrim të parave apo financim të terrorizmit? (FATF R.26.5)
2.6.6 A ka NjIF-i pavarësinë dhe autonominë e mjaftueshme funksionuese për të siguruar që është e lirë nga ndikimet apo ndërhyrjet e parregullta? (FATF R.26.6)
2.6.7 A është informacioni i cili mbahet nga NjIF-i i mbrojtur në mënyrë të sigurt dhe i shpërndarë vetëm në përputhje me ligjin? (FATF R.26.7)
2.6.8 A nxjerr NjIF-i në mënyrë publike raporte periodike që të përfshijnë statistika, tipologji dhe prirje, si dhe informacion për veprimtarinë e saj? (FATF R.26.8)
2.6.9 A ka marrë parasysh NjIF-i bërjen e kërkesës për anëtarësim në Grupin Egmont? (FATF R.26.9)

2.6.10 A e ka marrë parasysh NjIF-i Deklaratën e Qëllimit dhe Parimet e saj të Grupit Egmont për shkëmbimin e informacionit ndërmjet njësive të inteligjencës financiare për rastet e pastrimit të parave (këto dokumente përbëjnë udhëzime të rëndësishme në lidhje me rolin dhe funksionet e NjIF-ve dhe mekanizmat për shkëmbimin e informacionit midis NjIF-ve)? (FATF R.26.10)
2.6.11 A është zbatuar neni 25(1) i Direktivës në juridiksionin tuaj? (D3PP neni 25(1))
2.6.12 A ka miratuar Kosova masa legislative dhe të tjera që lejojnë ndërmarrjen e veprimeve urgjente nga NjIF-i apo, sipas rastit, nga ndonjë autoritet apo organ tjetër kompetent kur ekziston dyshimi se një transaksion është i lidhur me pastrimin e parave, për ta pezulluar apo për të mos dhënë pëlqimin për një transaksion në kryerje e sipër më qëllim që ta analizojë transaksionin dhe të vërtetojë dyshimin? Ju lutem jepni dispozitat e legjislacionit vendas, rregulloret dhe masat e tjera në lidhje me këtë. (CETS 198 neni 14)
2.6.13 A kufizohen masa të tilla në Kosovë në rastet kur është dorëzuar një raport i një transaksioni të dyshimtë? (CETS 198 neni 14)
2.6.14 Cila është kohëzgjatja maksimale e pezullimit apo e mosdhënies së pëlqimit për një transaksion sipas legjislacionit tuaj të brendshëm? (CETS 198 neni 14)
2.6.15 A mbajnë autoritetet kompetente statistika gjithëpërfshirëse për: (a) raportet e transaksioneve të dyshimta, dhe raportet e tjera kur është e përshtatshme sipas ligjit vendas, të marra dhe të shpërndara; (i) RTD-të e marra nga NjIF-i, përfshirë zbërthimin e llojit të institucionit financiar, BPPJF-ve, apo të bizneseve ose personave të tjerë të cilët bëjnë RTD-të; (ii) Zbërthimin e RTD-ve të analizuara dhe të shpërndara; (iii) Transfertet telegrafike ndërkombëtare (Është e pranueshme nëse këto statistika mbahen nga një agjenci tjetër); (iv) RTD-të që kanë rezultuar në hetime, ndjekje penale apo dënime për pastrim të parave, financim të terrorizmit apo vepra penale kryesore që qëndrojnë pas tyre. (FATF R.32.2, 32.3). Ju lutem të tregoni çfarëdo të dhëne apo materiali tjetër që i konsideroni të jenë të përshtatshëm për efektivitetin dhe efikasitetin e kësaj pjesë të sistemit të luftimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.
2.6.16 A është NjIF-i në Kosovë e strukturuar, financiar dhe e plotësuar me personelin e duhur si dhe a është e sigurt me burime të mjaftueshme teknike dhe të tjera që të mund të kryejë plotësisht dhe në mënyrë efektive detyrat e saj? (FATF R.30.1)

2.6.17 A kërkohet që personeli i NjIF-it të mbajë standarde të larta të profesionalizmit, përfshirë standardet në lidhje me konfidencialitetin, integritetin/ndershmërinë dhe aftësitë e duhura? (FATF R.30.2)
2.6.18 A i është ofruar personelit të NjIF-it trajnim përkatës dhe i përshtatshëm për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit? (FATF R.30.3)

2.7 Autoritetet e zbatimit të ligjit

2.7.1 A ka Kosova autoritete të përcaktuara të zbatimit të ligjit të cilat kanë përgjegjësi për të siguruar që veprat penale të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit të hetohen në mënyrën e duhur? (FATF R.27.1)

2.7.2 A i është dhënë konsideratë marrjes së masave, qoftë legjislative apo të tjera, që lejojnë autoritetet kompetente të cilat janë duke hetuar rastet e pastrimit të parave për të shtyrë apo për të hequr dorë nga arrestimi i personave të dyshuar dhe/ose për të sekuestruar paratë me qëllimin e identifikimit të personave të përfshirë në veprimtari të tilla apo për mbledhjen e provave? (FATF R.27.2)

2.7.3 A ka masa ekzistuese, qoftë legjislative apo të tjera, të cilat u sigurojnë autoriteteve të zbatimit të ligjit apo të ndjekjes penale një bazë ligjore të përshtatshme për të përdorur në një masë të gjerë teknikat e veçanta hetimore gjatë hetimit për pastrim të parave ose financim të terrorizmit (p.sh.: dorëzimi i kontrolluar i të ardhurave nga krimi apo i fondeve të destinuar për t'u përdorur për terrorizëm, operacionet e fshehta, etj.)? (FATF R.27.3)

2.7.4 Kur teknikat e veçanta hetimore janë të lejuara, a përdoren këto teknika gjatë hetimit për pastrim të parave, financim të terrorizmit dhe për veprat penale kryesore që qëndrojnë pas tyre, dhe deri në çfarë mase shfrytëzohen ato? (FATF R.27.4)

2.7.5 Përveç teknikave të veçanta të hetimit, a shfrytëzohen edhe mekanizmat e efektshëm si më poshtë?

(a) Grupe të përhershme apo të përkohshme të specializuara në hetimin e të ardhurave nga krimi (hetuesit financiarë)? Një përbërës i rëndësishëm i punës së këtyre grupeve apo organeve do të përqendrohet në hetimin, sekuestrimin, ngrirjen dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi. (FATF R.27.5(a))

(b) Hetimet bashkëpunuese me autoritetet e duhura kompetente në vendet e tjera, përfshirë përdorimin e teknikave të veçanta hetimore, me kusht që të jenë vendosur masat mbrojtëse të duhura? (FATF R.27.5(b))

2.7.6 A rishikohen metodat, teknikat dhe prirjet e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit nga autoritetet e zbatimit të ligjit, NJIF-i dhe autoritetet e tjera kompetente (sipas rastit) rregullisht dhe mbi bazën e marrëdhënieve ndërmjet agjencive? A i shpërndahen informatat, analizat apo studimet personelit të agjencive të zbatimit të ligjit dhe NJIF-it, si dhe personelit të autoriteteve të tjera kompetente? (FATF R.27.6)

2.7.7. A kanë autoritetet kompetente përgjegjëse për kryerjen e hetimeve të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe të veprave penale kryesore që qëndrojnë pas tyre

kompetenca që të jenë në gjendje: a) të detyrojnë prodhimin e, b) të kontrollojnë personat dhe objektet për, dhe c) të sekuestrojnë dhe marrin regjistrime të transaksioneve, të dhëna identifikuese të marra përmes procesit të VDK-së, skedarë të llogarive, korrespondencë të biznesit, dhe të dhëna të tjera, dokumente apo informata, të mbajtura nga institucionet financiare dhe nga bizneset apo personat e tjerë? (FATF R.28.1)
2.7.8 A kanë autoritetet kompetente të përmendura më lart kompetenca që të jenë në gjendje të marrin deklaratat e dëshmitarëve për t'i shfrytëzuar ato në hetimin dhe ndjekjen penale të veprave të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit si dhe të veprave tjera kryesore që qëndrojnë pas tyre apo në veprimet në lidhje me to? (FATF R.28.2)
2.7.9 A janë autoritetet e zbatimit të ligjit dhe të ndjekjes penale në Kosovë të strukturuar, të financuara dhe të plotësuara siç duhet me personelin e nevojshëm si dhe a janë të siguruar me burime të mjaftueshme teknike dhe të tjera që të mund të kryejnë plotësisht dhe në mënyrë efektive detyrat e tyre? (FATF R.30.1)
2.7.10 A kërkohet që personeli i autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe të ndjekjes penale në Kosovë të mbajë standarde të larta të profesionalizmit, përfshirë standardet në lidhje me konfidencialitetin, integritetin/ndershmërinë dhe aftësitë e duhura? (FATF R.30.2)
2.7.11 A i është ofruar personelit të autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe të ndjekjes penale në Kosovë trajnim përkatës dhe i përshtatshëm për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit? (FATF R.30.3)
2.7.12 A janë dhënë trajnime të veçanta apo programe edukative për gjyqtarët dhe gjykatat në lidhje me veprat penale të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, dhe në lidhje me sekuestrimin, ngrirjen dhe konfiskimin e pronës e cila është e ardhur nga krimi apo e cila përdoret për financimin e terrorizmit? (FATF R.30.4)

2.8 Deklarimi apo zbulimi ndërkufitar

2.8.1 A ka zbatuar Kosova një nga dy sistemet e mëposhtme për transportin ndërkufitar hyrës dhe dalës¹¹ të valutës dhe të instrumenteve të këmbyeshme të mbajtësit me qëllim që të zbulojë transportin fizik ndërkufitar të valutës dhe të instrumenteve të këmbyeshme të mbajtësit të cilat janë të lidhura me pastrimin e parave dhe me financimin e terrorizmit:

(a) Një sistem deklarimi i cili i ka veçoritë e mëposhtme:

(i) Të gjithë personave që kryejnë transport fizik ndërkufitar të valutës ose të instrumenteve të këmbyeshme të mbajtësit, të cilat janë në një vlerë që tejkalon pragu e përcaktuar do t'u kërkohej të dorëzojnë një deklaratë të vërtetë pranë autoriteteve kompetente të përcaktuara; dhe

(ii) Pragu i përcaktuar nuk duhet të tejkalojë 15,000¹² EUR/USD.

APO

(b) Një sistem zbulimi i cili ka veçoritë e mëposhtme:

(i) Të gjithë personave që kryejnë transport fizik ndërkufitar të valutës ose të instrumenteve të këmbyeshme të mbajtësit do t'u kërkohej që të dorëzojnë një deklaratë të vërtetë tek autoritetet kompetente të përcaktuara sipas kërkesës; dhe

(ii) Autoritetet kompetente të përcaktuara duhet të kenë autoritetin për të bërë hetimet/kërkimet e tyre mbi bazë shënjimi, në bazë të informacionit ose dyshimit, apo në mënyrë të rastësishme. (FATF RV.IX.1)

2.8.2 A kanë autoritetet kompetente në Kosovë autoritet që të kërkojnë dhe të marrin informata plotësuese nga transportuesit në lidhje me origjinën e valutës dhe të instrumenteve të këmbyeshme të mbajtësit dhe qëllimin e përdorimit të tyre kur ato konstatojnë një deklaratë/zbulim të rremë të valutës dhe të instrumenteve të këmbyeshme të mbajtësit apo mungesën e deklaramit/zbulimit të tyre? (FATF RV.IX.2)

2.8.3 A janë autoritetet kompetente në Kosovë në gjendje për të ndaluar apo kufizuar valutën ose instrumentet e këmbyeshme të mbajtësit për një kohë të arsyeshme me qëllim që të sigurojnë nëse mund të gjenden prova të pastrimit të parave apo të financimit të terrorizmit:

(a) Kur ekziston dyshimi i pastrimit të parave apo i financimit të terrorizmit; apo

(b) Kur ekziston një deklaram/zbulim i rremë.

(FATF RV.IX.3)

2.8.4 A e marrin autoritetet përkatëse sasinë e valutës ose të instrumenteve të këmbyeshme të mbajtësit të deklaruar/zbuluar apo të gjetura në një mënyrë tjetër, dhe të dhënat identifikuese të mbajtësit/ve në rastet kur:

(a) Është bërë një deklaram i cili e tejkalon pragu e përcaktuar; apo

(b) Është bërë një deklaram/zbulim i rremë; apo

11 Juridiksionet nuk janë të detyruara të përdorin të njëjtin lloj sistemi për transportin ndërkufitar hyrës dhe dalës të valutës dhe të instrumenteve të këmbyeshme të mbajtësit.

12 Juridiksionet që zbatojnë sistemin e deklarimit duhet të sigurojnë se pragu i përcaktuar është mjaftueshëm i ulët që të përmbushë objektivat e Rekomandimit të Veçantë IX. Në asnjë mënyrë, pragu nuk mund të tejkalojë 15,000 EUR/USD.

(c) Ekziston dyshimi për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit. (FATF RV.IX.4)
2.8.5 A janë informatat e marra përmes proceseve të zbatuara sipas FATF.RV.IX.1 (më sipër) në dispozicion të Njësisë së Inteligjencës Financiare (NjIF) qoftë nëpërmjet: Një sistemi ku NjIF-i njoftohet në lidhje me incidentet e transportit ndërkufitar të dyshimtë; APO Duke e vënë deklarin/zbulimin e informatave drejtpërdrejt në dispozicion të NjIF-it në ndonjë mënyrë tjetër. (FATF RV.IX.5)
2.8.6 A ka bashkëpunim të përshtatshëm në nivelin vendas midis doganës, zyrës së imigrimit dhe autoriteteve të tjera përkatëse për çështje që lidhen me zbatimin e FATF RV.IX? (FATF RV.IX.6)
2.8.7 Në nivelin ndërkombëtar, a e lejon Kosova në masën më të madhe të mundshme bashkëpunimin dhe ndihmën ndërmjet autoriteteve kompetente? (FATF RV.IX.7)
2.8.8 A munden autoritetet e Kosovës të zbatojnë sanksione ndaj personave që bëjnë deklarin apo zbulim të rremë, si dhe personave të cilët kryejnë transport fizik ndërkufitar të valutës ose instrumenteve të këmbyeshme të mbajtësit të cilat lidhen me financimin e terrorizmit apo pastrimin e parave? (FATF RV.IX.8, 9)
2.8.9 A munden autoritetet e Kosovës të zbatojnë masat e ngrirjes, sekuestrimit dhe të konfiskimit ndaj personave të cilët kryejnë transport fizik ndërkufitar të valutës ose instrumenteve të këmbyeshme të mbajtësit që lidhen me financimin e terrorizmit apo pastrimin e parave? (FATF RV.IX.10,11).
2.8.10 Nëse Kosova zbulon një lëvizje të pazakontë ndërkufitare të arit, metaleve të çmuara apo gurëve të çmuar, a e merr në konsideratë që të njoftojë, sipas rastit, Shërbimin Doganor apo autoritetet e tjera kompetente të vendeve nga të cilat këto e kanë prejardhjen dhe/ose në të cilat këto janë drejtuar, dhe të bashkëpunojë për vërtetimin e burimit, drejtimit dhe qëllimit të lëvizjes së sendeve të tilla dhe për marrjen e veprimeve të nevojshme? (FATF RV.IX.12)
2.8.11 A u nënshtrohen sistemet e raportimit të transaksioneve ndërkufitare masave të rrepta mbrojtëse për të siguruar përdorimin e duhur të informacionit apo të dhënave të cilat janë raportuar apo regjistruar? (FATF RV.IX.13)

2.8.12 A janë autoritetet doganore në Kosovë të strukturuar, të financuara dhe të plotësuara siç duhet me personelin e nevojshëm si dhe a janë të siguruara me burime të mjaftueshme teknike dhe të tjera që të mund të kryejnë plotësisht dhe në mënyrë efektive detyrat e tyre? (FATF R.30.1)
2.8.13 A kërkohet që autoritetet doganore në Kosovë të mbajnë standarde të larta të profesionalizmit, përfshirë standardet në lidhje me konfidencialitetin, integritetin/ndershmërinë dhe aftësitë e duhura? (FATF R.30.2)
2.8.14 A janë ofruar trajnime përkatëse të duhura për autoritetet doganore në Kosovë për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit? (FATF R.30.3)
2.8.15 A mbajnë autoritetet kompetente në Kosovë statistika gjithëpërfshirëse për transportin ndërkufitar të valutës dhe instrumenteve të këmbyeshme të mbajtësit (FATF R.32.2)? Ju lutem tregoni çfarëdo të dhëne apo material tjetër që i konsideroni të jenë të përshtatshëm për efektivitetin dhe efikasitetin e kësaj pjesë të sistemit të luftimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.

3. Masat parandaluese – Institucionet financiare

Ju lutem jepni një pamje të përgjithshme të saktë të shtrirjes së mbulimit të masave parandaluese të luftës kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit dhe zbatimit të tyre në sektorin financiar (shih gjithashtu seksionin 1.3 më sipër për një përkufizim të *institucioneve financiare*) ndërmjet të tjerash, cilët sektorë mbulohen dhe deri në çfarë mase?

3.1 Rreziku i pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizmit

Një juridiksion mund të vendosë të mos zbatojë disa kërkesa të caktuara të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ose të zvogëlojë apo të thjeshtojë masat që duhet të merren, në bazë të asaj se a ekziston një rrezik i vogël apo i ulët i pastrimit të parave apo i financimit të terrorizmit. A ka marrë Kosova vendim që të mos zbatojë disa masa të kërkuara në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për një sektor financiar të veçantë në bazë të një analize të rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit meqë ato kanë të bëjnë me lloje të veçanta të klientësh, marrëdhëniesh biznesi, transaksionesh apo produktesh? Nëse po, ju lutem përcaktoni bazat mbi të cilat është marrë një vendim i tillë.

3.2 Vigjilenca e duhur ndaj klientëve

3.2.1 A lejohet që institucionet financiare të mbajnë llogari anonime apo llogari me emra fiktivë? (FATF R.5.1)

3.2.2 A kërkohet që institucionet financiare të ndërmarrin masa për vigjilencën e duhur ndaj klientit (VDK) kur:

- a) vendosin marrëdhënie biznesi;
- b) kryejnë transaksione të rastit mbi pragun e përcaktuar të zbatueshëm (15,000 USD/€);
- c) kryejnë transaksione të rastit të cilat janë transferta telegrafike;
- d) ekziston dyshimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, pavarësisht ndonjë përjashtimi apo pragu; ose
- e) institucioni financiar ka dyshime në lidhje për vërtetësinë apo mjaftueshmërinë e të dhënave të siguruar më parë për identifikimin e klientit? (FATF R.5.2)

3.2.3 A kërkohet që institucionet financiare të identifikojnë klientët (qofshin ata të përhershëm apo të rastit, dhe qofshin ata persona fizikë apo juridikë a marrëveshje juridike) dhe të verifikojnë identitetin e klientëve duke shfrytëzuar dokumente, të dhëna apo informata burimore të pavarura dhe të besueshme (të dhëna identifikuese)? (FATF R.5.3)

3.2.4 Për klientët të cilët janë persona juridikë apo marrëveshje juridike, a kërkohet që institucioni financiar të:

- (a) verifikojë se çdo person që pretendon se vepron në emër të klientit është i autorizuar për këtë, dhe të identifikojë dhe verifikojë identitetin e këtij personi; dhe

(b) verifikojë statusin ligjor të personit juridik ose marrëveshjes juridike ¹³ ? (FATF R.5.4)
3.2.5 A kërkohet që institucionet financiare të identifikojnë pronarin përfitues ¹⁴ , dhe të marrin masat e arsyeshme për të verifikuar identitetin e pronarit përfitues duke përdorur informata përkatëse apo të dhëna të siguruara nga burime të besueshme të tilla që institucioni financiar të jetë i kënaqur se ka dijeni se kush është pronari përfitues? (FATF R.5.5)
3.2.6 Për të gjithë klientët, a duhet që institucioni financiar të përcaktojë nëse klienti është duke vepruar në emër të një personi tjetër, dhe të ndërmarrë hapat e arsyeshëm për të siguruar të dhëna të mjaftueshme identifikuese për të verifikuar identitetin e atij personit tjetër? (FATF R.5.5.1)
3.2.7 Për klientët të cilët janë persona juridikë apo marrëveshje juridike, a kërkohet që institucioni financiar të ndërmarrë masat e arsyeshme për të: (a) kuptuar strukturën e pronësisë dhe të kontrollit të klientit; (b) përcaktuar se cilët janë personat juridikë që në fund të fundit zotërojnë dhe kontrollojnë klientin. (FATF R.5.5.2)
3.2.8 A kërkohet që institucionet financiare të sigurojnë informata për qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit? (FATF R.5.6)
3.2.9 A kërkohet që institucionet financiare të kryejnë vigjilencë të duhur të vazhdueshme në marrëdhëniet e biznesit? (FATF R.5.7)
3.2.10 A përfshin vigjilenca e duhur e vazhdueshme shqyrtimin e transaksioneve të ndërmarra gjatë vazhdimin të asaj marrëdhënieje për të siguruar që transaksionet të cilat janë duke u kryer janë në përputhje me njohuritë e institucionit për klientët, bizneset e tyre dhe profilin e riskut, dhe kur është e domosdoshme, burimet e financimit? (FATF R.5.7.1)
3.2.11 A kërkohet që institucionet financiare të sigurojnë që dokumentet, të dhënat apo informatat e mbledhura gjatë procesit të vigjilencës së duhur ndaj klientit, të mbahen të azhurnuara dhe të jenë të përshtatshme duke ndërmarrë rishikimin e regjistrimeve ekzistuese, në veçanti për kategoritë e klientëve apo të marrëveshjeve të biznesit me rrezik të lartë?

13 Verifikimi mund të kryhet duke marrë prova të përfshirjes apo dëshmi të ngjashme të themelimit apo ekzistencës, dhe duke marrë informata në lidhje me emrin e klientit, emrat e administruesve të besuar (për trustet), formën ligjore, adresën, drejtorët (për personat juridikë), dhe dispozitat të cilat rregullojnë autoritetin për të detyruar personat apo marrëveshjet juridike.

14 *Pronari përfitues* i referohet personit/personave juridikë të cilët në fund të fundit zotërojnë ose kontrollojnë një klient dhe/ose një person në emër të të cilit është kryer një transaksion. Ai përfshin gjithashtu ata persona të cilët ushtrojnë kontroll efektiv përfundimtar ndaj personave apo marrëveshjeve juridike.

(FATF R.5.7.2)
3.2.12 A kërkohet që institucionet financiare të kryejnë vigjilencë të duhur të shtuar për kategoritë e klientëve, të marrëveshjeve të biznesit apo transaksioneve me rrezik të lartë? (FATF R.5.8)
3.2.13 Në rastet kur ekzistojnë rreziqe të ulëta, a munden institucionet financiare të zbatojnë masa të zvogëluara apo të thjeshtuara? (FATF R.5.9)
3.2.14 A lejohen institucionet financiare të zbatojnë masa të zvogëluara apo të thjeshtuara të vigjilencës së duhur ndaj klientit për klientët rezidentë në një juridiksion tjetër?
3.2.15 Kur ekziston dyshimi për pastrim të parave ose financim të terrorizmit apo nëse zbatohen skenarë të veçantë me rrezik të lartë, a janë të pranueshme masat e thjeshtuara të vigjilencës së duhur ndaj klientit? (FATF R.5.11)
3.2.16 Kur institucionet financiare lejohen që të përcaktojnë shtrirjen e masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit mbi bazën e një rreziku të ndjeshëm, a ekzistojnë kërkesa për të zbatuar udhëzimet e lëshuara nga autoritetet kompetente? (FATF R.5.12)
3.2.17 A kërkohet që institucionet financiare të verifikojnë identitetin e klientit dhe të pronarit përfitues para apo gjatë rrjedhës së vendosjes së marrëdhënies së biznesit apo gjatë kryerjes së transaksioneve për klientë të rastit? (FATF R.5.13)
3.2.18 A lejohen institucionet financiare në Kosovë të plotësojnë verifikimin e identitetit të klientit dhe të pronarit përfitues pas vendosjes së marrëdhënies së biznesit, me kusht që: (a) kjo të ndodhë sa më shpejt që të jetë e mundur. (b) kjo të jetë thelbësore për të mos ndërprerë zhvillimin normal të biznesit. (c) Rreziqet e pastrimit të parave të menaxhohen në mënyrë efektive? (FATF R.5.14)
3.2.19 Kur klientit i lejohet ta shfrytëzojë marrëdhënien e biznesit para verifikimit, a kërkohet që institucionet financiare të miratojnë procedura të menaxhimit të rrezikut në lidhje me kushtet nën të cilat kjo mund të ndodhë? ¹⁵ (FATF R.5.14.1)

15 Këto procedura duhet të përfshijnë një gamë masash, si kufizimi i numrit, llojeve dhe/ose sasisë së transaksioneve, të cilat mund të kryhen dhe monitorimi i transaksioneve të mëdha apo të ndërlikuara të cilat kryhen jashtë normave të pritshme për atë lloj marrëdhënieje.

3.2.20 Nëse institucioni financiar nuk është në gjendje të përmbushë kriteret (FATF R.5.3 to 5.6) e mësipërme: a) a lejohet që të hapet llogari, të nisë marrëdhënie biznesi apo të kryejë transaksionin? b) a kërkohet që të merret parasysh kryerja e një raporti të transaksionit të dyshimtë? (FATF R.5.15)
3.2.21 Nëse institucioni financiar ka filluar tashmë marrëdhëniet e biznesit, a ekziston ndonjë kërkesë për të përfunduar marrëdhënien e biznesit dhe të merret parasysh kryerja e një raporti të transaksionit të dyshimtë? (FATF R.5.16)
3.2.22 A kërkohet që institucionet financiare të zbatojnë kërkesat e vigjilencës së duhur ndaj klientit për klientët ekzistues mbi bazën e rëndësisë dhe rrezikut dhe të kryhet vigjilencë e duhur në kohën e përshtatshme për marrëdhënie të tilla ekzistuese? (FATF R.5.17)
3.2.23 A kërkohet që institucionet financiare të zbatojnë masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit për klientët ekzistues nëse ata janë klientë ndaj të cilëve zbatohet kriteri 5.1? (FATF R.5.18)
3.2.24 Cila është pozita në juridiksionin tuaj në lidhje me librezat e kursimit me emra fiktivë? (D3PP neni 6)
3.2.25 Në përputhje me rekomandimet FATF, duhet të kërkohet që institucionet financiare të ndërmarrin masa të vigjilencës së duhur ndaj klientit kur kryejnë transaksione të rastit <i>mbi</i> pragun e përcaktuar të zbatueshëm. A janë transaksionet dhe transaksionet e lidhura të <i>barasvlershme</i> me shumën prej 15 000 EUR të mbuluara? (D3PP neni 7 b)
3.2.26 Cila qasje ndiqet në Kosovë për përkufizimin e “pronarit përfitues”? Ju lutem specifikoni nëse kriteret në përkufizimin e BE-së për “pronarin përfitues” janë të mbuluara në legjislacionin tuaj. (D3PP neni 3(6))

3.3 Personat e ekspozuar politikisht (PEP)

3.3.1 A kërkohet që institucionet financiare të vendosin sisteme të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut për të përcaktuar nëse klienti i mundshëm, një klient apo pronari përfitues është person i ekspozuar politikisht? (FATF R.6.1)
3.3.2 A kërkohet që institucionet financiare të marrin miratimin e menaxherëve të nivelit të lartë për të vendosur marrëdhënie biznesi me një PEP? (FATF R.6.2)
3.3.3 Kur një klient është pranuar dhe klienti apo pronari përfitues është gjetur më pas të jetë, apo bëhet më pas një person i ekspozuar politikisht, a kërkohet që institucionet financiare të marrin miratimin e menaxherëve të nivelit të lartë për të vazhduar marrëdhënien e biznesit? (FATF R.6.2.1)
3.3.4 A kërkohet që institucionet financiare të ndërmarrin masat e arsyeshme për të vërtetuar burimin e pasurisë dhe burimin e fondeve të klientëve dhe pronarëve përfitues të identifikuar si persona të ekspozuar politikisht? (FATF R.6.3)
3.3.5 Kur institucionet financiare janë në marrëdhënie biznesi me një person të ekspozuar politikisht, a kërkohet që ato të bëjnë monitorimin e shtuar dhe të vazhdueshëm të asaj marrëdhënie? (FATF R.6.4)
3.3.6 A i përfshijnë kërkesat e mësipërme personat e ekspozuar politikisht të cilët mbajnë funksione të larta në vend? (FATF R.6.5)
3.3.7 A është nënshkruar, ratifikuar dhe/ose zbatuar plotësisht Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit e vitit 2003? (FATF R.6.6)
3.3.8 A e zbaton Kosova nenin 2 të Direktivës së Komisionit 2006/70/EC, në veçanti nenin 2(4), dhe a janë nenet 13(4) të Direktivës të zbatueshme? (D3PP neni 3(8), 13(4))

3.4 Ligjet për ruajtjen e fshehtësisë që janë në përputhje me rekomandimet

A e pengon zbatimin e Rekomandimeve të FATF ndonjë ligj për ruajtjen e sekreteve të institucioneve financiare? (FATF R.4.1)

--

3.5 Mbajtja e regjistrave

3.5.1 A kërkohet që institucionet financiare të mbajnë të gjitha regjistrimet e domosdoshme për transaksionet, vendore dhe ndërkombëtare, për së paku pesë vite pas plotësimit të transaksionit (ose më gjatë nëse kërkohet nga një autoritet kompetent në raste të veçanta dhe në bazë të autoritetit të duhur)? (FATF R.10.1)

3.5.2 A janë regjistrimet e transaksioneve të mjaftueshme për të lejuar rindërtimin e transaksioneve individuale dhe për të siguruar, nëse është e nevojshme, dëshmi për ndjekjen penale të veprimtarisë kriminale? (FATF R.10.1.1)

3.5.3 A kërkohet që institucionet financiare të mbajnë regjistrime për të dhënat identifikuese, skedarët e llogarive dhe për korrespondencën e biznesit për së paku pesë vite pas mbylljes së një llogarie apo përfundimit të marrëdhënies së biznesit (ose më gjatë nëse kërkohet nga një autoritet kompetent në raste të veçanta dhe në bazë të autoritetit të duhur)? (FATF R.10.2)

3.5.4 A kërkohet që institucionet financiare të sigurojnë që të gjithë regjistrimet për klientët dhe transaksionet dhe informacioni të jenë në dispozicion në kohën e duhur për autoritetet kompetente vendase në bazë të autoritetit të duhur? (FATF R.10.3)

3.6 Raportimi i transaksioneve të dyshimta në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit

3.6.1 A kërkohet me ligj që institucionet financiare t'i raportojnë NjIF-it (raportim i transaksioneve të dyshimta – RTD) kur ato dyshojnë apo kanë bazë të arsyeshme për të dyshuar që fondet janë të ardhura nga veprimtari kriminale? (FATF R.13.1)
3.6.2 A zbatohet gjithashtu detyrimi për të bërë një raportim të transaksioneve të dyshimta për fondet ku ekzistojnë baza të arsyeshme për të dyshuar apo për të cilat dyshohet që janë të lidhura apo janë në lidhje me, apo janë për t'u shfrytëzuar për terrorizëm, akte terroriste apo nga organizatat terroriste ose nga ata të cilët financojnë terrorizmin? (FATF R.13.2)
3.6.3 A është bërë raportimi i të gjitha transaksioneve të dyshimta në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, përfshirë transaksionet në tentativë, pavarësisht shumës së transaksionit? (FATF R.13.3 dhe RV.IV.2)
3.6.4 A zbatohet kërkesa për të raportuar transaksionet e dyshimta pavarësisht nëse, përveç të tjerash, mendohet se ato përfshijnë çështje tatimore? (FATF R.13.4 dhe RV.IV.2)
3.6.5 A kërkohet që institucionet financiare t'i raportojnë Njësisë për Inteligjencë Financiare kur ato dyshojnë apo kanë bazë të arsyeshme për të dyshuar që fondet janë të ardhura nga të gjitha veprimet kriminale të cilat përbëjnë një vepër penale kryesore të pastrimit të parave në nivel vendas? (FATF R.13.5)
3.6.6 A kërkohet me ligj apo rregullore që institucionet financiare t'i raportojnë NjIF-it (raportim i transaksioneve të dyshimta – RTD) kur ato dyshojnë apo kanë bazë të arsyeshme për të dyshuar që fondet janë të lidhura apo janë në lidhje me, apo janë për t'u shfrytëzuar për terrorizëm, akte terroriste apo nga organizatat terroriste ose nga ata të cilët financojnë terrorizmin? (FATF RV.IV.1)

3.7 Mbrojtja dhe ndalimi i zbulimit të informacionit

3.7.1 A janë institucionet financiare dhe drejtorët, zyrtarët dhe punonjësit e tyre (të përhershëm dhe të përkohshëm) të mbrojtur me ligj nga përgjegjësia penale dhe civile për shkelje të ndonjë kufizimi për zbulimin e informatave që imponohet me kontratë apo me ndonjë dispozitë ligjore, rregullatore apo administrative, nëse ata i raportojnë dyshimet e tyre në mirëbesim tek NJIF-i? (FATF R.14.1)

3.7.2 A ndalohen me ligj institucionet financiare dhe drejtorët, zyrtarët dhe punonjësit e tyre (të përhershëm dhe të përkohshëm) nga zbulimi i faktit se ndonjë RTD apo informatë e lidhur është duke iu raportuar apo dhënë NJIF-it? (FATF R.14.2)

3.7.3 A sigurojnë ligjet, rregulloret apo masat e tjera që emrat dhe hollësitë personale të personelit të institucioneve financiare që bëjnë RTD mbahen konfidenciale nga NJIF-i? (FATF R.14.3)

3.7.4 A zbatohet Neni 27 i Direktivës në juridiksionin tuaj (D3PP Neni 27)

3.7.5 Në çfarë rrethanash zbatohen detyrimet për zbulimin e informacionit? A ka përjashtime? (D3PP Neni 28)

3.7.6 A ka masa legislative apo të tjera për të siguruar që bankat nuk i zbulojnë klientit bankar përkatës apo palës së tretë informatat që janë kërkuar apo marrë sipas nënparagrafëve a, b apo c të Nenit 7 (2) apo që ndonjë hetim është në zhvillim e sipër? Ju lutem ofroni legjislacionin përkatës dhe masat e tjera. (CETS 198 Neni 7)

3.8 Bankat Guaskë (pa prani fizike në vend)

3.8.1 A ka marrë masa Kosova për të ndaluar themelimin apo operimin e vazhdueshëm të bankave guaskë? (FATF R.18.1)
3.8.2 A janë marrë masa për të parandaluar institucionet financiare që të vendosin kontakte apo të vazhdojnë marrëdhëniet bankare korresponduese me bankat guaskë? (FATF R.18.2)
3.8.3 A kërkohet që institucionet financiare të sigurohen se institucionet financiare pjesëmarrëse në ndonjë juridiksion tjetër të mos i lejojnë llogaritë e tyre të përdoren nga bankat guaskë? (FATF R.18.3)

3.9 Mbikëqyrja dhe Monitorimi i Vazhdueshëm dhe Hyrja në Treg

3.9.1 A i nënshtrohen institucionet financiare rregulloreve të duhura kundër pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit dhe mbikëqyrjes dhe a zbatohen në mënyrë efektive rekomandimet e FATF? (FATF R.23.1)
3.9.2 A kanë autoritetet kompetente të përcaktuara përgjegjësi për të siguruar që institucionet financiare i respektojnë siç duhet kërkesat për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit? (FATF R.23.2)
3.9.3 A ndërmarrin mbikëqyrësit apo autoritetet e tjera kompetente masat e nevojshme ligjore apo rregullatore për të parandaluar kriminelët apo bashkëpunëtorët e tyre nga mbajtja apo të qenit pronarë përfitues të ndonjë interesi të konsiderueshëm apo kontrollues ose mbajtja e një funksioni menaxhues, përfshirë në bordet ekzekutive apo mbikëqyrëse, këshillat, etj. në ndonjë institucion financiar? (FATF R.23.3)
3.9.4 A u nënshtrohen drejtorët apo menaxherët e nivelit të lartë të institucioneve financiare Parimeve Themelore të vlerësuara mbi bazën e kriterit “të qenit i përshtatshëm dhe i duhur” përfshirë ato që kanë të bëjnë me ekspertizën dhe integritetin? (FATF R.23.3.1)
3.9.5 Për institucionet financiare që u nënshtrohen Parimeve Themelore, a zbatohen masat rregullatore dhe mbikëqyrëse që vlejné për qëllime të kujdesshme dhe që janë gjithashtu të përshtatshme për pastrimin e parave, në një mënyrë të ngjashme edhe për qëllimet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit? (FATF R.23.4)

3.9.6 A janë personat fizikë dhe juridikë që ofrojnë shërbime të transferimit të parave apo të vlerës, ose shërbime të këmbimit valutor, të licencuar apo të regjistruar? (FATF R.23.5)
3.9.7 A u nënshtrohen personat fizikë dhe juridikë që ofrojnë shërbime të transferimit të parave apo të vlerës, apo shërbime të këmbimit valutor sistemeve efektive për monitorimin dhe sigurimin e përputhshmërisë me kushtet vendase për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit? (FATF R.23.6)
3.9.8 A janë institucionet financiare (përveç atyre të përmendura në FATF R.23.4) të licencuara apo të regjistruara dhe të rregulluara siç duhet, dhe a i nënshtrohen mbikëqyrjes ose monitorimit për qëllime të luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit? (FATF R.23.7)
3.9.9 A janë autoritetet mbikëqyrëse në Kosovë të strukturuar, financuara, të plotësuara me staf në mënyrë të përshtatshme dhe a janë të pajisura me burime të mjaftueshme teknike dhe të tjera për të kryer plotësisht dhe në mënyrë efektive funksionet e tyre? (FATF R.30.1)
3.9.10 A kërkohet që autoritetet mbikëqyrëse në Kosovë të mbajnë standarde të larta profesionale, përfshirë standardet për konfidencialitetin, integritetin/ndershmërinë dhe aftësitë e duhura? (FATF R.30.2)
3.9.11 A kanë përfituar autoritetet mbikëqyrëse në Kosovë trajnime të përshtatshme dhe përkatëse për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit? (FATF R.30.3)
3.9.12 A mbajnë autoritetet kompetente në Kosovë statistika gjithëpërfshirëse për shqyrtimet e kryera nga mbikëqyrësit në terren që kanë të bëjnë me luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe sanksionet e vëna? (FATF R.32.2). Ju lutem tregoni çdo të dhënë apo materiale të tjera që i konsideroni të duhura për efektivitetin dhe efikasitetin e kësaj pjese të sistemit për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

3.10 Mbikëqyrësit

3.10.1 A kanë mbikëqyrësit kompetenca të përshtatshme për të monitoruar dhe për të siguruar përputhshmëri nga ana e institucioneve financiare, me kërkesat për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit? (FATF R.29.1)

3.10.2 A kanë mbikëqyrësit autoritetin për të kryer inspektime të institucioneve financiare, përfshirë inspektimet në terren, për të siguruar përputhshmëri dhe a përfshijnë inspektimet shqyrtimin e politikave, procedurave, librave dhe regjistrimeve/shënimeve, dhe a shtrihen ato në testimin e shembujve? (FATF R.29.2)

3.10.3 A kanë mbikëqyrësit kompetenca për të detyruar prodhimin e të gjitha shënimeve, dokumenteve apo informatave që janë të rëndësishme për monitorimin e përputhshmërisë, apo për të siguruar qasje në to?¹⁶ (FATF R.29.3)

3.10.4 A ka nevojë kompetenca e mbikëqyrësit që të kërkojë urdhër nga gjykata për të detyruar prodhimin apo sigurimin e qasjes për qëllimet e mbikëqyrjes? (FATF R.29.3.1)

3.10.5 A kanë mbikëqyrësit kompetenca të duhura të zbatimit dhe të sanksioneve kundër institucioneve financiare, dhe drejtorëve të tyre apo menaxherëve të nivelit të lartë për mospërputhje apo për moszbatim të duhur të kërkesave për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit? (FATF R.29.4)

¹⁶ Kjo përfshin të gjitha dokumentet dhe informatat në lidhje me llogaritë ose marrëdhëniet e tjera të biznesit, apo transaksionet, përfshirë çdo analizë të mundshme që institucioni financiar ka bërë për të zbuluar transaksione të pazakonta apo të dyshimta.

3.11 Sanksionet

3.11.1 A ka Kosova sanksione penale, civile apo administrative në fuqi që janë efektive, proporcionale dhe shtrënguese për personat fizikë apo juridikë, të cilët nuk i respektojnë kushtet për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit? (FATF R.17.1)

--

3.11.2 A ka përcaktuar Kosova një autoritet (p.sh. mbikëqyrësit apo NjIF-i) me kompetencë për zbatimin e sanksioneve? (FATF R.17.2)

--

3.11.3 A ka sanksione në fuqi në lidhje jo vetëm me personat juridikë që janë institucione financiare apo biznese por edhe me drejtorët dhe menaxherët e lartë të tyre? (FATF R.17.3)

--

3.11.4 A janë llojet e sanksioneve në dispozicion të gjera dhe në përpjesëtim me peshën e situatës? A përfshijnë sanksionet kompetencën për të dhënë sanksione disiplinore dhe financiare dhe kompetencën për të tërhequr, kufizuar apo pezulluar licencën e institucionit financiar, aty ku është e zbatueshme? (FATF R.17.4)

--

3.12 Shërbimet e transferimit të parasë apo të vlerës

3.12.1 A ka përcaktuar Kosova një apo më shumë autoritete kompetente për të regjistruar dhe/ose licencuar persona fizikë dhe juridikë për të kryer shërbime të transferimit të parasë apo të vlerës (operatorë të shërbimeve të TPV-së), për të mirëmbajtur një listë aktuale të emrave dhe adresave të operatorëve të shërbimeve të TPV-së të licencuar dhe/ose të regjistruar, dhe për të qenë përgjegjëse për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e licencimit dhe/apo të regjistrimit? (FATF RV.VI.1)

3.12.2 A ka Kosova një sistem në fuqi për monitorimin e operatorëve të shërbimeve të TPV-së dhe për sigurimin se ata janë në përputhje me standardet për luftimin kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit? (FATF RV.VI.2)

3.12.3 A kërkohet në Kosovë që çdo operator i licencuar apo i regjistruar i shërbimeve të TPV-së të mirëmbajë një listë aktuale të agentëve të tyre e cila duhet t'i vihet në dispozicion autoritetit të përcaktuar kompetent? (FATF RV.VI.2)

3.13 Teknikat bashkëkohore të transaksioneve të sigurta

A ka ndërmarrë Kosova masa për të inkurajuar zhvillimin dhe përdorimin e teknikave bashkëkohore dhe të sigurta për kryerjen e transaksioneve financiare që janë më pak të ekspozuara ndaj rrezikut të pastrimit të parave.

Shembuj të teknikave apo masave që mund të jenë më pak të ekspozuara ndaj rrezikut të pastrimit të parave përfshijnë:

- *Uljen e varësisë prej parave të gatshme;*
- *Moslëshimin e bankënotave shumë të mëdha;*
- *Sisteme të automatizuara të sigurta për transferta. (FATF R.20.2)*

4. Personat juridikë – Qasja në informacionin rreth pronësisë së vlefshme dhe kontrollit

4.1 A ka ndërmarrë Kosova masa për të parandaluar përdorimin e paligjshëm të personave juridikë në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit duke siguruar që ligjet e saj për çështje ekonomike, për persona juridikë dhe ligje të tjera të kërkojnë transparencën e duhur lidhur me pronësinë e vlefshme dhe kontrollin e personave juridikë? (FATF R.33.1)

Shembuj të mekanizmave që mund të përdoren për të siguruar ekzistencën e transparencës së duhur mund të përfshijnë:

1. Një sistem të regjistrimit qendror ku një regjistër i brendshëm regjistron hollësitë e kërkuara rreth pronësisë dhe kontrollit për të gjitha kompanitë dhe personat e tjerë juridikë të regjistruar në atë juridiksion. Informacioni përkatës mund të jetë qoftë në dispozicion edhe të publikut apo vetëm i vlefshëm për autoritetet kompetente. Ndryshimet e informatave rreth pronësisë dhe kontrollit do të kenë nevojë të mbahen të përditësuara.

2. Kërkesa ndaj ofruesve të shërbimeve të kompanive për marrjen, verifikimin dhe mbajtjen e shënimeve të pronësisë së vlefshme dhe kontrollit të personave juridikë.

3. Mbështetjen në kompetencat hetuese dhe të tjera të autoriteteve të zbatimit të ligjit, autoriteteve kompetente rregullatore, mbikëqyrëse apo të tjera në ndonjë juridiksion për të marrë informata apo për të pasur qasje në to.

Këta mekanizma janë në një shkallë të gjerë plotësues dhe juridiksionet mund ta vlerësojnë përdorimin e kombinuar të tyre si shumë të dëshirueshëm dhe të dobishëm.

Deri në atë masë që juridiksionet mbështeten në kompetencat hetuese të autoriteteve të tyre kompetente, këto autoritete duhet të kenë kompetenca mjaftueshëm të fuqishme detyruese me qëllimin e marrjes së informatave përkatëse.

Cilido mekanizëm që të përdoret, është thelbësorë që: (a) autoritetet kompetente të mund të marrin apo të kenë qasje në një kohë të arsyeshme në informatat rreth pronësisë së vlefshme dhe kontrollit, (b) informatat të jenë të përshtatshme, të sakta dhe të merren në kohë dhe (c) autoritetet kompetente të mund të ndajnë këto informata me autoritetet kompetente të tjera brenda apo jashtë vendit.

4.2 A munden autoritetet kompetente të jenë në gjendje të marrin apo të kenë qasje në një kohë të arsyeshme në informacionin e duhur, të saktë dhe aktual rreth pronësisë së vlefshme dhe kontrollit të personave juridikë? (FATF R.33.2)

5. Organizatat jofitimprurëse

5.1 A ka kryer Kosova ndonjë shqyrtim rreth përshtatshmërisë së ligjeve dhe rregulloreve të brendshme që kanë të bëjnë me organizatat jofitimprurëse si dhe a ka bërë ndonjë studim të veprimtarive, madhësisë dhe të veçorive të tjera përkatëse të sektorëve jofitimprurës me qëllimin e identifikimit të veçorive dhe llojeve të organizatave jofitimprurëse (OJF) që janë të rrezikuara nga shpërdorimi për financim të terrorizmit apo për pastrim të parave për arsye të veprimtarive apo veçorive të tyre? (FATF RV.VIII.1)

5.2 A ka ndërmarrë Kosova ndonjë fushatë ndërgjegjësimi për sektorin e organizatave jofitimprurëse me qëllimin e mbrojtjes së sektorit nga shpërdorimi i financimit të terrorizmit /pastrimit të parave? (FATF RV.VIII.2)

5.3 A është ndërmarrë ndonjë hap për të promovuar mbikëqyrjen apo monitorimin efektiv të atyre organizatave jofitimprurëse të cilat përmbajnë: (i) një pjesë domethënëse të burimeve financiare nën kontrollin e sektorit; dhe (ii) një pjesë domethënëse të veprimtarive ndërkombëtare të sektorit? (FATF RV.VIII.3)

5.4 A kërkohet që OJF-të të mbajnë informata për: (1) qëllimin dhe objektivat e veprimtarive të tyre të deklaruar; dhe (2) identitetin e personit (personave) që zotërojnë, kontrollojnë apo drejtojnë veprimtaritë e tyre, përfshirë zyrtarët e lartë, anëtarët e bordit apo administruesit e besuar? (FATF RV.VIII.3.1)

5.5 A ka masa të duhura në fuqi për sanksionimin e shkeljeve të masave apo rregullave të mbikëqyrjes/monitorimit nga OJF-të apo personat që veprojnë në emër të OJF-ve. (FATF RV.VIII.3.2)

5.6 A janë OJF-të e licencuara apo të regjistruara nga autoritetet kompetente? (FATF RV.VIII.3.3)

5.7 A kërkohet që OJF-të të mbajnë, për një periudhë prej të paktën pesë vitesh, dhe t'i vënë në dispozicion tek autoritetet e duhura, shënimet e transaksioneve vendase dhe ndërkombëtare që kanë hollësi të mjaftueshme për të verifikuar se fondet janë shpenzuar në një mënyrë që përputhet me qëllimin dhe objektivat e organizatës? (FATF RV.VIII.3.4)

5.8 A ka zbatuar Kosova masa për të siguruar që ajo mund të hetojë dhe të mbledhë informata në mënyrë efektive rreth OJF-ve? (FATF RV.VIII.4)
5.9 A ka themeluar Kosova një sistem efektiv të bashkëpunimit, bashkërendimit dhe shkëmbimit të informacionit të brendshëm në masën e mundshme ndërmjet të gjitha niveleve të autoriteteve apo organizatave të duhura që kanë informacion përkatës për OJF-të që ngrenë shqetësime të mundshme për financimin e terrorizmit/pastrimin e parave? (FATF RV.VIII.4.1)
5.10 A mund të merret qasje e plotë në informacion rreth administrimit dhe menaxhimit të ndonjë OJF-je të caktuar (përfshirë informacionin financiar dhe programor) gjatë zhvillimit të ndonjë hetimi? (FATF RV.VIII.4.2)
5.11 A ka Kosova ekspertizë dhe aftësi hetuese për të shqyrtuar ato OJF që dyshohen qoftë për shfrytëzim në veprimtaritë apo nga organizatat terroriste ose që janë në mbështetje aktive të tyre? A ka mekanizma në fuqi që mundësojnë veprime të shpejta hetuese apo parandaluese kundër këtyre OJF-ve? (FATF RV.VIII.4.3)
5.12 A ka pika të duhura të kontaktit dhe procedura për të reaguar ndaj kërkesave ndërkombëtare për informata lidhur me ndonjë OJF të caktuar që dyshohet për financim të terrorizmit apo për ndonjë formë tjetër të mbështetjes terroriste? (FATF RV.VIII.5)

6. Bashkëpunimi ndërkombëtar

6.1 Bashkëpunimi dhe bashkërendimi

6.1.1 A kanë politikëbërësit, NjIF-i, autoritetet e zbatimit të ligjit dhe mbikëqyrësit si dhe autoritetet e tjera kompetente mekanizma efektivë në fuqi që u mundëson atyre bashkëpunimin, dhe aty ku është e nevojshme, bashkërendimin e brendshëm ndërmjet tyre lidhur me zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe të veprimtarive për luftimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit? (FATF R.31.1)

6.1.2 A ka mekanizma në fuqi për konsultime mes autoriteteve kompetente, sektorit financiar dhe sektorëve të tjerë që u nënshtrohen ligjeve për luftimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, rregulloreve, udhëzimeve apo masave të tjera? (FATF R.31.2)

6.2 Ndhimja e ndërsjellë juridike

6.2.1 Ju lutem jepni një listë të detyrimeve shumëpalëshe të bazuara në traktate të cilat kanë të bëjnë me ndihmën ligjore në çështjet penale (përfshirë veprat penale të luftimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit) të cilat zbatohen në Kosovë apo të atyre që planifikohen të ratifikohen në të ardhmen.

6.2.2 A është Kosova në gjendje të ofrojë gamën më të gjerë të mundshme të ndihmës së ndërsjellë juridike për hetimet, ndjekjet penale dhe procedurat e tjera përkatëse të LPP/FT¹⁷? (FATF R.36.1)

6.2.3 A është Kosova në gjendje ta ofrojë këtë ndihmë në kohë të arsyeshme dhe në mënyrë konstruktive dhe efektive? (FATF R.36.1.1)

6.2.4 A ka ndonjë pengesë për ofrimin e ndihmës së ndërsjellë juridike? (FATF R.36.2)

6.2.5 A ka Kosova procese të qarta dhe efektive për ekzekutimin e kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike në një kohë të arsyeshme dhe pa vonesa të panevojshme? (FATF R.36.3)

6.2.6 A mund të refuzohet ndonjë kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike me arsyetimin e vetëm se vepra konsiderohet gjithashtu se përfshin çështje tatimore? (FATF R.36.4)

6.2.7 A mund të refuzohet ndonjë kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike me arsyetimin e ligjeve që parashikojnë kërkesa për fshehtësinë apo konfidencialitetin kundrejt institucioneve financiare apo BPPJF-ve, përveç rasteve ku informatat përkatëse janë marrë në rrethana ku zbatohet privilegji profesional ligjor apo fshehtësia profesionale ligjore? (FATF R.36.5)

6.2.8 A kanë autoritetet kompetente kompetenca në dispozicion për t'i përdorur për përgjigjet ndaj kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike? (FATF R.36.6)

¹⁷ Ndhimja e ndërsjellë juridike duhet të përfshijë ndihmën e kësaj natyre: (a) prodhimin, kërkimin dhe sekuestrimin e informacionit, dokumenteve apo të provave (përfshirë regjistrimet/shënimet financiare) nga institucionet financiare apo personat e tjerë fizikë apo juridikë; (b) marrjen e provave apo të deklaratave nga personat; (c) ofrimin e origjinaleve apo të kopjeve të dokumenteve apo regjistrimeve përkatëse dhe të çdo informate tjetër apo elementi provues, (d) ndikimin e shërbimit të dokumenteve gjyqësore; (e) lehtësimin e shfaqjes vullnetare të personave me qëllimin e sigurimit të informatave apo të dëshmimeve për juridiksionin që i kërkon ato dhe (f) identifikimin, ngrirjen, sekuestrimin, apo konfiskimin e pasurive të pastruara apo të synuara për t'u pastruar, të ardhurat nga pastrimi i parave dhe pasuritë e përdorura apo që synohet të përdoren për financimin e terrorizmit, si dhe instrumentet e këtyre veprave dhe pasuritë në vlerë përkatëse.

6.2.9 Për të shmangur konflikte të juridiksionit, a ka shqyrtuar Kosova mundësinë që të krijohen dhe të përdoren mekanizma për përcaktimin e vendit më të mirë për ndjekjen penale të të pandehurve në interes të drejtësisë për rastet që i nënshtrohen ndjekjes penale në më shumë se një juridiksion? (FATF R.36.7)
6.2.10 A janë kompetencat e autoriteteve kompetente që kërkohen në R.28 në dispozicion për t'u përdorur aty ku ka kërkesë të drejtpërdrejtë nga autoritetet e jashtme gjyqësore apo ato të zbatimit të ligjit ndaj homologëve vendas? (FATF R.36.8)
6.2.11 A e lejon juridiksioni juaj ekstradimin e shtetasve në rastet e luftimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit? Nëse jo, nën cilat kushte autoritetet kompetente në juridiksionin tuaj i ndjekin penalisht ata?
6.2.12 Ju lutem tregoni cilat konventa dhe traktate ndërkombëtare për luftimin kundër pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit janë ratifikuar apo planifikohet të ratifikohen në të ardhmen.

6.3 Ndhimja e ndërsjellë juridike për konfiskimin dhe ngrirjen e pasurisë

6.3.1 A ka ligje dhe procedure të duhura për dhënien e përgjigjes efektive dhe në kohë të arsyeshme ndaj kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike të shteteve të huaja në lidhje me identifikimin, ngrirjen, sekuestrimin apo konfiskimin e:

(a) pronës së pastruar nga,

(b) të ardhurave nga,

(c) instrumenteve të përdorura në, apo

(d) instrumenteve të synuara për t'u përdorur në,

kryerjen e ndonjë veprë të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo të ndonjë veprë tjetër kryesore që qëndron pas tyre? (FATF R.38.1)

6.3.2 A plotësohen kushtet e lartpërmendura edhe kur kërkesa ka të bëjë me pronë të vlerës përkatëse? (FATF R.38.2)

6.3.3 A ka pasur Kosova marrëveshje për bashkërendimin e veprimeve të sekuestrimit dhe të konfiskimit me vende të tjera? (FATF R.38.3)

6.3.4 A e ka shqyrtuar Kosova mundësinë e themelimit të një fondi të pasurive të konfiskuara në të cilin do të depozitohen të gjitha apo ndonjë pjesë e pasurive të konfiskuara dhe i cili do të përdoret për qëllime të zbatimit të ligjit, shëndetësisë, arsimit apo qëllime të tjera të përshtatshme? (FATF R.38.4)

6.3.5 A e ka marrë parasysh Kosova çështjen e autorizimit të ndarjes së pasurive të konfiskuara midis tyre kur konfiskimi është drejtpërdrejt apo tërthorazi rezultat i veprimeve të bashkërenduara për zbatimin e ligjit? (FATF R.38.5)

6.3.6 A njihen dhe zbatohen urdhrat që vijnë nga jashtë në lidhje me konfiskimet jopenale? (FATF R.38.6)

6.4 Mënyrat e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar

6.4.1 A janë në gjendje autoritetet kompetente në Kosovë që t'iu ofrojnë homologëve të tyre jashtë vendit gamën më të gjerë të bashkëpunimit ndërkombëtar? (FATF R.40.1)
6.4.2 A është Kosova në gjendje ta ofrojë këtë ndihmë në mënyrë të shpejtë, konstruktive dhe efektive? (FATF R.40.1.1)
6.4.3 A ka Kosova rrugë, mekanizma apo kanale të qarta dhe efektive që do të lehtësonin dhe mundësonin shkëmbimin e shpejtë dhe konstruktiv të informacionit drejtpërdrejt ndërmjet homologëve? (FATF R.40.2)
6.4.4 A janë këto shkëmbime të informacionit të mundshme: (a) si në mënyrë spontane ashtu edhe në bazë të një kërkesë dhe (b) në lidhje qoftë me veprat e pastrimit të parave ashtu edhe me veprat kryesore që qëndrojnë pas tyre? (FATF R.40.3)
6.4.5 A janë të gjitha autoritetet kompetente në Kosovë të autorizuar për të kryer hetime në emër të homologëve të tyre të huaj? (FATF R.40.4)
6.4.6 A është NjIF-i e autorizuar që të bëjë llojet e mëposhtme të hetimeve në emër të homologëve të huaj: (a) kërkimin e bazave të veta të të dhënave, përfshirë informacionin në lidhje me raportet për transaksione të dyshimta; (b) kërkimin e bazave të tjera të të dhënave në të cilat mund të ketë qasje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, përfshirë bazat e të dhënave për zbatimin e ligjit, bazat publike të të dhënave, bazat administrative të të dhënave dhe bazat e të dhënave të vlefshme me pagesë? (FATF R.40.4.1)
6.4.7 A janë autoritetet për zbatimin e ligjit të autorizuar për të kryer hetime në emër të homologëve të huaj? A janë autorizuar autoritetet e tjera kompetente për të kryer hetime në emër të homologëve të huaj, aty ku kjo lejohet me ligjin vendas? (FATF R.40.5)
6.4.8 A mund të refuzohet bashkëpunimi me arsyetimin e vetëm se kërkesa konsiderohet gjithashtu se përfshin çështje tatimore? (FATF R.40.7)
6.4.9 A mund të refuzohen kërkesat për bashkëpunim me arsyetimin e ligjeve që përcaktojnë kushte të mbajtjes së fshehtësisë apo të konfidencialitetit për institucionet financiare apo

BPPJF-të (përveç kur informacioni përkatës që kërkohet mbahet në rrethanat ku zbatohet privilegji profesional juridik apo fshehtësia profesionale juridike? (FATF R.40.8)
6.4.10 A ka themeluar Kosova kontrole apo mënyra të ruajtjes për të siguruar që informacioni i marrë nga autoritetet kompetente përdoret vetëm në mënyrë të autorizuar? (FATF R.40.9)
6.4.11 A ka mekanizma në fuqi për të lejuar shkëmbimin e shpejtë dhe konstruktiv të informacionit me palët që nuk janë homologe? A kryhet kjo në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë? (FATF R.40.10)
6.4.12 A e zbulon autoriteti kërkues në praktikë tek autoriteti marrës/i kërkuar qëllimin e kërkesës dhe organin në emër të së cilit bëhet kërkesa? (FATF R.40.10.1)
6.4.13 A mundet NjIF-i të marrë nga autoritetet e tjera kompetente apo nga personat e tjerë informacionin përkatës që kërkohet nga ndonjë NjIF homologe e huaj? (FATF R.40.11)
6.4.14 A keni marrë masat e nevojshme për të përcaktuar, si përgjigje ndaj kërkesës së dërguar nga pala tjetër, nëse një person fizik apo juridik që është subjekt i një hetimi penal mban apo kontrollon një apo më shumë llogari, të çfarëdo natyre, në ndonjë bankë të vendosur në territorin tuaj? Ju lutem jepni dispozitat përkatëse ligjore apo shpjegoni procesin/procedurën. (CETS 198 Neni 17.1)
6.4.15 A e bëni ekzekutimin e një kërkesë sipas kushteve të njëjta që keni zbatuar në lidhje me kërkesat për kërkim dhe sekuestrim? Ju lutem jepni dispozitat përkatëse ligjore apo shpjegoni procesin/procedurën. (CETS 198 Neni 17.4)
6.4.16 A e keni shtrirë këtë nen për institucionet financiare jobankare? Nëse po, ju lutem shpjegoni se për cilat institucione financiare zbatohen këto dispozita. Ju lutem jepni dispozitat përkatëse ligjore apo shpjegoni procesin/procedurën. (CETS 198 Neni 17.6)
6.4.17 Çfarë masash legislative keni ndërmarrë për të siguruar se me kërkesë të ndonjë pale tjetër, ju i ofroni hollësitë e llogarive bankare të caktuara dhe të operacioneve bankare që janë kryer gjatë një periudhe kohore të caktuar, përmes një apo më shumë llogarive të specifikuara në kërkesë, përfshirë hollësitë e llogarive dërguese apo marrëse? Ju lutem jepni dispozitat përkatëse ligjore apo shpjegoni procesin/procedurën. (CETS 198 Neni 18.1)

6.4.18 A e keni shtrirë këtë nen për institucionet financiare jobankare? Nëse po, ju lutemi shpjegoni se për cilat institucione financiare zbatohen këto dispozita. (CETS 198 Neni 18.5)
6.4.19 Me kërkesë të ndonjë pale tjetër, a keni kompetenca për të monitoruar, gjatë një periudhe specifike, operacionet bankare që kryhen përmes një apo më shumë llogarive të specifikuara në kërkesë dhe për t'i komunikuar rezultatet e tyre tek pala kërkuese? (CETS 198 Neni 19.1)
6.4.20 A e keni shtrirë këtë nen për institucionet financiare jobankare? Nëse po, ju lutem shpjegoni se për cilat institucione financiare zbatohen këto dispozita. (CETS 198 Neni 19.5)
6.4.21 A mund të refuzohet bashkëpunimi me arsyetimin se kërkesa ka të bëjë me një vepër tatimore, kur vepra lidhet gjithashtu me financimin e terrorizmit? Nëse po, ju lutem jepni arsytet. (CETS 198 Neni 28.1d)
6.4.22 A mund të refuzohet bashkëpunimi me arsyetimin se kërkesa ka të bëjë me një vepër politike, kur vepra lidhet gjithashtu me financimin e terrorizmit? Nëse po, ju lutem jepni arsytet. (CETS 198 Neni 28.1e)
6.4.23 A ofrohet bashkëpunimi edhe nëse personi nën hetim apo që i nënshtrohet urdhrat të konfiskimit nga autoritetet e palës kërkuese përmendet në kërkesë jo vetëm si autor i veprës penale kryesore por dhe si autor i veprës së pastrimit të parave? Nëse në këtë situatë nuk ofrohet bashkëpunimi, ju lutem shpjegoni arsyen. (CETS 198 Neni 28.8c)
6.4.24 Cilat dispozita ligjore iu mundësojnë autoriteteve tuaja gjyqësore, përfshirë edhe prokurorët publikë, në rast të urgjencës të dërgojnë kërkesat dhe komunikimet sipas këtij kreu drejtpërdrejt tek këto autoritete të një pale tjetër? A është gjithashtu e mundur që në të njëjtën kohë të dërgohet një kopje e kërkesës apo e komunikimit tek autoriteti qendror i palës së kërkuar përmes autoritetit tuaj qendror? (CETS 198 Neni 34.2)
6.4.25 A kanë mundësi autoritetet e palës kërkuese që të kontaktojnë autoritetet tuaja vendase drejtpërdrejt para dërgimit të kërkesës formale, për të siguruar se ajo mund të trajtohet me efektivitet pas pranimit dhe që ajo të përmbajë informacionin e mjaftueshëm dhe dokumentacionin mbështetës për të përmbushur kushtet tuaja ligjore? (CETS 198 Neni 34.6)
6.4.26 A mundet NjIF-i të bashkëpunojë me të gjitha llojet e NjIF-ve, pavarësisht faktit se ato janë administrative, gjyqësore apo për zbatimin e ligjit? Çfarë masash ekzistojnë për të

siguruar që NjIF-i juaj ka mundësi të bashkëpunojë me NjIF-et e tjera pavarësisht statusit të tyre të brendshëm? (CETS 198 Neni 46.3)
6.4.27 A shoqërohen kërkesat e bëra sipas këtij neni me një deklaratë të shkurtër për faktet përkatëse për të cilat NjIF-i juaj ka dijeni? (CETS 198 Neni 46.4)
6.4.28 A e specifikon NjIF-i juaj në kërkesë mënyrën e përdorimit të informatave të kërkuara? (CETS 198 Neni 46)
6.4.29 Kur bëhet ndonjë kërkesë në përputhje me këtë nen, a i ofron NjIF-i juaj të gjitha informatat përkatëse, përfshirë informatat financiare të qasshme dhe të dhënat që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit, të cilat kërkohen në kërkesë, pa nevojën për një letër formale të kërkesës sipas konventave dhe marrëveshjeve në fuqi mes palëve? Ju lutemi shpjegoni procesin dhe procedurat ekzistuese për përmbushjen e këtyre detyrimeve në një afat të arsyeshëm dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse. (CETS 198 Neni 46.5)
6.4.30 A refuzon NjIF-i juaj dhënien e informatave? Me çfarë baze, siç parashikohet në këtë nen, e refuzon apo do ta kishte refuzuar NjIF-i juaj dhënien e informatave? (CETS 198 Neni 46.6)
6.4.31 A i shpjegohen NjIF-it që kërkon informata refuzimet në mënyrën e duhur? (CETS 198 Neni 46)
6.4.32 A e përcaktojnë dhe e kufizojnë qartë legjislacioni dhe masat e tjera përdorimin e informatave dhe dokumenteve të marra nga NjIF-i juaj në mënyrë që ato të mos mund të shpërndahen tek ndonjë palë e tretë apo të përdoren për ndonjë qëllim tjetër përveç analizimit pa pëlqimin paraprak të NjIF-it që ofron informatat? (CETS 198 Neni 46.7)
6.4.33 Kur bëhet transmetimi i informatave apo i dokumenteve sipas këtij neni, a imponon NjIF-i juaj kufizime dhe kushte për përdorimin e informatave nga NjIF-i pranues për qëllime të tjera përpos atyre të parashikuara në paragrafin 7? (CETS 198 Neni 46.8)
6.4.34 Si zbatohet neni 46 (9) në legjislacionin apo procedurat tuaja? Ju lutem shpjegoni së mbi çfarë baze NjIF-i transmetues do të refuzonte lejimin e transmetimit të informatave që kanë për qëllim të përdoren për hetime apo ndjekje penale? (CETS 198 Neni 46.9)

6.4.35 Çfarë masash të nevojshme, përfshirë masat e sigurisë, ndërmerr NjIF-i juaj për të siguruar që informatat e dorëzuara siç parashikohet në këtë nen nuk janë të qasshme nga asnjë autoritet tjetër, agjenci, apo departament? (CETS 198 Neni 46.10)
6.4.36 Si zbatohet neni 46 (11) në legjislacionin apo praktikën tuaj në lidhje me konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale? (CETS 198 Neni 46.11)
6.4.37 A bën pyetje/a kërkon informata NjIF-i juaj në lidhje me përdorimin e informatave të transmetuara dhe a merr komente për informatat e transmetuara, apo në rastet kur ju jeni NjIF-i pranues, a jepni komente? (CETS 198 Neni 46.12)
6.4.38 A ka masa ligjore apo të tjera në fuqi për të lejuar nisjen e veprimit urgjent nga NjIF-i, me kërkesë të ndonjë NjIF-i të huaj, për të pezulluar apo tërhequr pëlqimin për ndonjë transaksion që është në zhvillim e sipër për ato periudha dhe varësisht nga kushtet e njëjta që zbatohen në ligjin vendas në lidhje me shtyrjen e transaksioneve? (CETS 198 Neni 47)

Shtojcat

Shtojca 1: Lista e kategorive të veprave penale e FATF-së

Kategoritë e veprave penale të përcaktuara sipas FATF-së	Neni (nenet) në Kodin Penal
Pjesëmarrja në një grup të organizuar kriminal dhe shantazhi	
Terrorizmi, përfshirë financimin e terrorizmit	
Trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabanda e migrantëve	
Shfrytëzimi seksual, përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve	
Trafikimi i paligjshëm i drogave narkotikëve dhe i lëndëve psikotrope	
Trafikimi i paligjshëm i armëve	
Trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhura dhe mallrave të tjera	
Korrupsioni dhe ryshfeti	
Mashtrimi	
Falsifikimi i monedhës	
Falsifikimi dhe pirateria e produkteve	
Krimet mjedisore	
Vrasja dhe plagosja e rëndë trupore	
Rrëmbimi, kufizimi dhe pengmarrja e paligjshme	
Vjedhja ose plaçkitja	
Kontrabanda	
Grabitja me dhunë	
Falsifikimi	
Pirateria	
Manipulimi i shitblerjes së letrave me vlerë dhe i tregut	

Shtojca 2: Lista e kategorive të veprave penale e CETS Nr. 198

Kategoritë e veprave penale në shtojcën e CETS Nr. 198	Veprat në legjislacionin vendas
a) Pjesëmarrja në një grup të organizuar kriminal dhe shantazhi	
b) Terrorizmi, përfshirë financimin e terrorizmit	
c) Trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabanda e emigrimit	
d) Shfrytëzimi seksual, përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve	
e) Trafikimi i paligjshëm i drogave narkotike dhe i lëndëve psikotrope	
f) Trafikimi i paligjshëm i armëve	
g) Trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhura dhe mallrave të tjera	
h) Korrupsioni dhe ryshfeti	
i) Mashtrimi	
j) Falsifikimi i monedhës	
k) Falsifikimi dhe pirateria e produkteve	
l) Krimi mjedisor	
m) Vrasja dhe plagosja e rëndë trupore	
n) Rrëmbimi, kufizimi dhe pengmarrja e paligjshme	
o) Vjedhja ose plaçkitja	
p) Kontrabanda	
q) Zhvatja	
r) Falsifikimi	
s) Pirateria; dhe	
t) Manipulimi i shitblerjes së letrave me vlerë dhe i tregut.	

Shtojca 3: Shkurtime

Shkurtimi	Përshkrimi
BPPJF	Bizneset dhe Profesionet e Përcaktuara Jofinanciare
CETS	Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës
D3PP	Direktiva e Tretë për Pastrimin e Parave (2005/60/EC)
FATF	Task Forca e Veprimit Financiar
LPP/FT	Luftimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
NjIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
OV	Organizata Vetërregulluese
PEP	Personat e Ekspozuar Politikisht
PKEK	Projekti kundër Krimit Ekonomik në Kosovë
RTD	Raport i Transaksionit të Dyshimtë
RV	Rekomandim i Veçantë (9 Rekomandimet e Veçanta të FATF-së për Financimin e Terrorizmit)
RVN	Raport i Vlerësimit të Ndërsjellë
S/RES	Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
TPV	Transferimi i Parasë apo Vlerës
VDK	Vigjilenca e Duhur ndaj Klientit

